

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/05/21;
Datë: 21.05.2021 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Muharrem Krasniqi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: mbledhja e pestë-(2021) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 28.05.2021, ora 14⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Formimi i grupit punues për hartimin e projekt-Planit të punës të Kuvendit Komunal të komunës së Junikut për vitin 2022;
3. Raporti Financiar Janar-Mars 2021 ;
4. Propozim-vendim për hartimin e Programit trevjeçar Komunal për banim 2021-2023;
5. Miratimi i draft- rregullores për menaxhimin e varrezave komunale;
6. Propozim vendimi për Plotësim-ndryshimin e rregullores për: Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Mirënjohjet dhe Falenderimet në Komunën e Junikut;
7. Të ndryshme



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-04/21
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	30.04.2021
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së katërt (4) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2021 me datë: 30.04.2021, në ora 14:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut z. Muharrem Krasniqi, i cili në fillim përshëndeti të gjithë, Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, Nënkryetarin z. Faik Tofaj, kolegët e nderuar Asambleistët, Drejtorët e Drejtorive Komunale, zyrtarët Komunal dhe të pranishmit.

Mbledhja u organizua duke respektuar udhëzimet e IKSHPK-së.

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi - Kryesues, AAK
2. Behare Qestaj - Anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi - Anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi - Anëtar, AAK
5. Albert Gjocaj - Anëtar, AAK
6. Xhemë Tofaj - Anëtar, AAK
7. Dardane Shala - Anëtare, AAK
8. Tahir Isufaj - Anëtar, LDK
9. Florim Shala - Anëtar, LVV
10. Blerim Gacaferi - Anëtar, PDK

11. Edona Shehu - Anëtare, LDK
12. Zenel Maloku – Anëtar, i pavarur
13. Gjyle Miroci – Anëtare, LVV
14. Zeqë Hebibi – Anëtar, LDK

Mungoi: Erleta Isufaj – Anëtare, LDK

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e muajit shkurt-2021,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2020 në vitin 2021,
4. Raport i Kryetarit të Komunës së Junikut rreth gjendjes Ekonomiko-Financiare të Komunës së Junikut,
5. Propozim-vendim për lirimin e bizneseve nga taksat komunale për vitin 2021, si masë përkrahëse për bizneset lokale në kohë pandemie,
6. Propozim për ndarjen e çmimit “ Kuvendi i Junikut ” për Heronjtë dhe Dëshmorët e rënë në Komunën e Junikut,
7. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: Propozoj një kërkesë nga Kryetari si pikë të veçantë të rendit të ditës, e cila ishte: Plotësim – ndryshimi i rregullorës, simbole, titujt të nderit, dekorata, mirënjohjet dhe falenderimet në Komunën e Junikut. Pastaj, e hodhi në votim dhe nga 14 prezent, 9 ishin për, 5 kundër, abstenim nuk kishte, kalon.

Tutje Kryesuesi e hapi diskutimin sa i përket rendit të ditës. I dha fjalën znj. Behare Qestaj në emër të grupit.

znj. Behare Qestaj: Përshendeti të gjithë të pranishmit dhe u pajtuan si grup me këto pika të rendit të ditës.

z. Muharrem Krasniqi: Pastaj i dha fjalën në emër të grupit z. Tahir Isufaj.

z. Tahir Isufaj: Nuk u pajtuan si grup dhe propozuan që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, të kenë material mjaftueshëm dhe të dihet se pse po bëhet ky ndryshim.

z. Muharrem Krasniqi: Shtoj se do të formohet një grup punues, do e marrin materialin që është në rregullorë dhe çka do të ndryshohet, do të kalojë në lexim të parë, të dytë dhe pastaj do të miratohet.

Iu dha mundësinë dikujt tjetër ta merr fjalën?

z. Zeqë Hebibi: U ankua që i është ndryshuar mbiemri në procesverbal.

z. Muharrem Krasniqi: Për procesverbal do diskutojmë tek pika për procesverbale.

E hodhi në votim këtë rend të ditës. Prezent 14, për 9, kundër 5, abstenim nuk kishte, kalon.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e muajit shkurt-2021.

z. Muharrem Krasniqi: E hapi diskutimin rreth kësaj pike dhe e pyeti z. Zeqë Hebibi për cilin procesverbal e kishte fjalën, për të muajit shkurt apo mars.

z. Zeqë Hebibi: E kishte ankesën për procesverbalin e muajit mars, ku i ishte ndryshuar mbiemri dhe për numrin e faqeve.

z. Muharrem Krasniqi: Nëse nuk e merr dhe dikush tjetër fjalën, e hedhi në votim. Kush është që të kaloj procesverbali i muajit shkurt? Kush ka ndonjë vërejtje?

z. Tahir Isufaj: Ndërhyri duke thënë se procesverbalin e muajit shkurt duhet diskutuar më gjatë dhe kërkoj sqarime rreth vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale konkretisht për Valavica në mahallën Berishë, kërkoi të dihet kush e ka marrur dhe si e ka marrur në shfrytëzim.

z. Muharrem Krasniqi: U përgjigj duke thënë se askush nuk e ka marrur, ky është vetëm vendim paraprak për ta japur në shfrytëzim si pronë.

z. Agron Kuçi: Kryetari ju sqaroi se Departamenti Ligjor i Ministrisë së MAPL-së ka kërkuar që Komuna e Junikut t'i drejtohet Agjensisë Kosovare të Privatizimit se a janë prona të tyre apo të Komunës së Junikut, por akoma nuk kemi marrur përgjigje. Dhe shtoi se prona është dhënë në shfrytëzim për 11 muaj konfrom ligjit, ku në marrëveshje ceket promovimi i vlerave kulturore dhe nëse nuk i përmbahen marrëveshjes atëherë ndërpritet kjo marrëveshje.

z. Muharrem Krasniqi: Nëse nuk keni diçka tjetër rreth procesverbalit të muajit shkurt, atëherë e hedhi në votim. Nga 14 prezent, 9 për, 5 kundër, abstenim nuk kishte, kalon.

Pika e dytë e rendit të ditës

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

z. Muharrem Krasniqi: Pyeti se a ka dikush ndonjë vërejtje përveç z. Zeqë Hebibi që i dha vërejtjet e tij, nëse jo e hedhi në votim. Nga 14 prezent, 11 ishin për, 3 kundër, abstenim nuk kishte, kalon.

Pika e tretë e rendit të ditës

3. Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2020 në vitin 2021.

z. Muharrem Krasniqi: Fjala për Drejtoreshën e Buxhetit dhe Financave.

znj. Kosovare Gacaferi Hadergjona: Përshëndeti të pranishmit dhe raportoi për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuar nga viti 2020 në vitin 2021.

z. Muharrem Krasniqi: Kryesuesi e hapi diskutimin dhe iu dha fjalën në emër të grupeve.

znj. Behare Qestaj: Si grup pajtohen me këtë pikë të rendit të ditës.

z. Tahir Isufaj: Kërkoi që ky raport të jetë më i detajizuar sa i përket asfaltimit të rrugëve lokale.

z. Muharrem Krasniqi: Ia dha fjalën Drejtorit të Urbanizmit z. Hasan Krasniqi.

z. Hasan Krasniqi: Ky është projekt 2 vjeçar, ku planifikohen të asfaltohen 2.5 km rrugë, është vazhdimësi e projektit të Asfaltimit të rrugëve lokale. Në projektin egzistues janë të identifikuar të gjitha rrugët ku i përmendi disa prej tyre.

z. Muharrem Krasniqi: Pasi nuk mori dikush tjetër fjalën, e hodhi në votim. Prezent 14, 9 për, 4 kundër, abstenim nuk ka, kalon.

Pika e katërt e rendit të ditës

4. Raport i kryetarit të Komunës së Junikut rreth gjendjes Ekonomiko-Financiare të Komunës së Junikut.

z. Muharrem Krasniqi: I dha fjalën Kryetarit z. Agron Kuçi.

z. Agron Kuçi: I përshëndeti gjithë të pranishmit dhe tha se Komuna pavarësisht sfidave pandemike nuk i ka ndalur aktivitetet e saja në të gjitha segmentet të cilat përkundër sfidave janë arritur objektivat e saja, mirpo akoma ka vend për punë dhe shumë projekte janë duke u realizuar. Kam sjellur para jush raportin për diskutim rreth gjendjes Ekonomiko-Financiare të Komunës së Junikut, në të cilin janë prezantuar të gjitha zhvillimet e komunës së Junikut, ofrimet e shërbimeve, zhvillimet e projekteve dhe menaxhimi i gjendjes në kohë pandemie. Jemi të hapur për pyetje dhe diskutim, këtu janë prezent dhe drejtorët nëse keni nevoj për ndonjë qartësim.

z. Muharrem Krasniqi: I dha fjalën znj. Qestaj në emër të grupit.

znj. Behare Qestaj: Në emër të grupit nuk kishin diçka kundër, pra u pajtuan.

z. Muharrem Krasniqi: I dha fjalën z. Tahir Isufaj në emër të grupit.

z. Tahir Isufaj: Tha se nuk e kishte lexuar raportin.

z. Muharrem Krasniqi: Fjala ju dha z. Zenel Maloku dhe pastaj z. Zeqë Hebibi.

z. Zenel Maloku: Ishte i kënaqur me raportin e Kryetarit.

z. Muharrem Krasniqi: Nëse nuk keni diçka tjetër, raporti do të thotë nuk votohet.

z. Zeqë Hebibi: Hapi temën për peticionin dhe kërkesën e lagjës Qendër drejtuar Komunës.

z. Agron Kuçi: Po kërkesën e kemi pranuar dhe kemi aplikuar në Ministrinë e Pushtetit Lokal me projektin për rrugën në Jasiq dhe për rrugën në lagjen Qendër, jemi të sigurtë që deri në fund të majit do ta nënshkruajmë marrëveshjen. Dhe i njoftojë anëtarët e Kuvendit që në disa raste kemi vonesa në ekzekutimin e kërkesave shkaku i procedurave.

z. Muharrem Krasniqi: Nëse nuk e do askush tjetër fjalën, atëherë kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës.

Pika e pestë e rendit të ditës

5. Propozim-vendim për lirimin e bizneseve nga taksat komunale për vitin 2021, si masë përkrahëse për bizneset lokale në kohë pandemie.

z. Muharrem Krasniqi: I dha fjalën Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik z. Leonard Llojluni.

z. Leonard Lllolluni: Përsëritet për të gjithë, siç e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së për faljen e borxheve të bizneseve për vitin 2021 që ushtrojnë veprimtarinë në Komunën e Junikut për shkak të pandemisë dhe si Komune nuk kemi pasur mundësi t'i subvencionojmë apo përkrahim andaj kemi menduar t'i përkrahim në këtë formë, edhe në mbledhjen e KPF-së u dakorduar të falen bizneset që shlyejnë borxhet paraprake si në vitin 2020 apo të iu shlyhet borxhi edhe atyre që nuk shlyejnë borxhet paraprake kjo mbetet tek ju dhe nëse ky propozim vendim kalon bizneseve që tashmë kanë paguar taksën komunale për vitin 2021 iu bartet në vitin e ardhshëm, para jush e keni listën e bizneseve me borxhe paraprake, borxhet paraprake që janë bartë janë 47,241.00 Euro, faturimi për vitin 2021 është 16,580.00 Euro, pasi që jemi në vit pandemik deri më tani kemi inkasuar vetëm 1,956.00 Euro, borxhi total i të gjitha viteve edhe për këtë vit është 61,865.00 Euro.

z. Muharrem Krasniqi: Faleminderit, pra siç e diskutuam edhe atë ditë ai që nuk i ka të shlyer borxhet paraprake të mos iu falen borxhet sepse po i stimulojmë njerëzit që nuk janë të rregullt edhe në KPF e vendosëm kështu që bizneset që shlyejnë borxhet paraprake të iu shlyhet borxhi për vitin 2021, ata që tashmë kanë paguar taksën për vitin 2021 të iu bartet për vitin tjetër.

Kryesuesi pastaj i dha fjalën znj. Dardane Shala.

znj. Dardane Shala: Kundërshtoj versionin që të iu falet borxhi vetëm atyre që shlyejnë borxhin paraprak sepse kjo po duket si një kusht që biznesi të paguaj borxhin paraprak në mënyrë që të përfitoj nga falja e borxhit. Si kusht po i bie.

z. Muharrem Krasniqi: Po, nuk mund t'i krahasojmë ata që janë të rregullt me ata që nuk paguajnë. Kjo po i bie që t'i fyejmë ata që janë të rregullt.

z. Leonard Lllolluni: Siç e kemi diskutuar edhe në KPF borxhi iu falet atyre që shlyejnë borxhin paraprak.

z. Muharrem Krasniqi: Ju lutemi me rend. Znj. Behare Qestaj në emër të grupit.

znj. Behare Qestaj: Ne si grup, përpos znj. Dardane pajtohem që të iu falet borxhi bizneseve të cilët paguajnë borxhin paraprak.

z. Tahir Isufaj: Edhe unë pajtohem.

z. Zeqë Hebibi: Unë nuk pajtohem as tani as atëherë.

z. Florim Shala: Edhe unë jam me i liru, siç jemi pajtu në KPF.

z. Zenel Maloku: Unë pajtohem me mendimin e Behares.

z. Muharrem Krasniqi: Atëherë e hedhim në votim, borxhi për vitin 2021 iu falet atyre që paguajnë borxhet paraprake dhe atyre që kanë paguar për këtë vit të iu shlyhet në vitin e ardhshëm, pasi që ka që disa kanë paguar tashmë. Pra e hedhim në votim.

znj. Behare Qestaj: Mendimi im personal, unë nuk jam që atyre që nuk kanë paguar kurrë të iu shlyhet borxhi.

z. Zenel Maloku: Pasi që po flasim për periudhën e faljes së borxhit në kohë pandemike edhe unë e ngrisë dorën.

z. Blerim Gacaferi: Njëjtë pajtohem dhe une.

z. Betim Gacaferi: Nëse po vendosim për t'iu ndihmuar bizneseve atëherë une jam që t'iu falen edhe atyre që nuk e kanë paguar borxhin.

znj. Dardane Shala: Një ndihmë ofrohet me kushte unë nuk e konsiderojë ndihmë.

z. Muharrem Krasniqi: E hedhi në votim këtë pikë të rendit të ditës. Nga 14 prezent, 9 për, 2 kundër, 3 abstenim, kalon.

Pika e gjashtë e rendit të ditës

6. Propozim për ndarjen e çmimit “ Kuvendi i Junikut ” për Heronjtë dhe Dëshmorët e rënë në Komunën e Junikut.

z. Muharrem Krasniqi: Në emër të grupit i dha fjalën znj. Behare Qestaj.

znj. Behare Qestaj: U pajtuan si grup.

z. Muharrem Krasniqi: z. Tahir Isufaj në emër të grupit.

z. Tahir Isufaj: Pyeti se a ka komision për ndarjen e çmimit.

z. Muharrem Krasniqi: Qartësoj se egziston lista nga qeveria e Heronjve dhe Dëshmorëve, pasi që një titull i tillë merret me vendim të qeverisë.

z. Agron Kuçi: Komuna e Junikut ka 26 heronjë dhe dëshmorë të Junikut duke përfshirë dhe ata që nuk janë nga Juniku por kanë rënë në Junik.

z. Muharrem Krasniqi: Pasi nuk e kërkoj dikush tjetër fjalën, e hedhi në votim. 14 prezent, 14 për, kundër asnjë, abstenim nuk ka, kalon.

Pika e shtatë e rendit të ditës

7. Të ndryshme

Pikë e veçantë të rendit të ditës: Plotësim – ndryshimi i rregullorës, simbole, titujt të nderit, dekorata, mirënjohjet dhe falenderimet në Komunën e Junikut.

z. Muharrem Krasniqi: Fjala për Kryetarin z. Agron Kuçi.

z. Agron Kuçi: Kam bërë një kërkesë për azhurim të rregullorës për simbole, titujt të nderit, dekorata, mirënjohjet dhe falenderime e cila përpos atyre që përmban kemi parë që ka nevojë edhe për plotësim me tituj të rinjë, e konsideroj që iu kemi mbetur borxh martirëve mirpo komisioni gjatë rishikimit do të ketë mundësinë për plotësim ndryshim me tituj të tjerë.

z. Muharrem Krasniqi: I dha fjalën znj. Behare Qestaj në emër të grupit.

znj. Behare Qestaj: Pajtohen në emër të grupit.

z. Tahir Isufaj: Nuk e kam parë këtë rregullore.

z. Muharrem Krasniqi: E qartëson se do të formohet komisioni, do të prezentohet rregullorja dhe pastaj do të hidhet në votim, është vetëm një propozim që të shtohen çmime të reja. Fjala për z. Zenel Maloku.

z. Zenel Maloku: Kërkoj të informohet se kuit deri më tani i është dhënë çmimi “ Nderi i Junikut ”.

z. Agron Kuçi: Çmimi “ Nderi i Junikut ” i është dhënë në vitin 2017 gjithë heronjëve, dëshmorëve dhe martirëve të Junikut.

z. Muharrem Krasniqi: E hedhi në votim. Nga 14 prezent, 14 ishin për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Tutje, kërkoj emrat e anëtarëve të komisionit.

AAK/PDK – Betim Gacaferi,

LDK/VV – Zeqë Hebibi,

Nga ekzekutivi – Venera Shala dhe Turim Ganiqaj,

Nga Shoqëria Civile – Nezir Shehu.

E hedhi në votim përbërjen e anëtarëve të komisionit. Dhe nga 14 prezent, 14 ishin për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Të ndryshme:

z. Agron Kuçi: Qartësoi mënyrën e shfrytëzimit të objektit të Valavicës deri më tani nga organizata YMCA për aktivitete rinore dhe me pasivizimin e aktiviteteve të tyre si shkak i pandemisë ka ardhur kërkesa nga një biznes për marrje me qera të objektit në përputhje me vlerat e trashëgimisë që bartë.

z. Tahir Isufaj: Konsideroj që nuk është formë e mirë e funksionalizimit të këtij objekti.

z. Agron Kuçi: Pasi që pati pakënaqësi propozoj formimin e një komisioni të përbërë nga pozita dhe opozita që nëse nuk respektohet kontrata nga biznesi në fjalë të i ndërprehet ushtrimi i veprimtarisë, kjo është forma më e mirë që të iu krijojmë qëndrueshmëri objekteve të trashëgimisë.

z. Muharrem Krasniqi: I dha fjalën z. Albert Gjocaj

z. Albert Gjocaj: Shprehi shqetësimin e tij për rrugën në Gjocaj (Ganiqaj-Malok), ku si shkak i të reshurave ka pasur rrëshqitje të dheut dhe rruga është e pakalushme, ku kërkoj nga Komuna të intervenohet.

z. Agron Kuçi: Njoftoj që pas dëmeve të shkaktuara nga të reshurat e vazhdueshme në fillimin e janarit, ku pati edhe rrëshqitje të dheut në shumë zona menjëherë është formuar komisioni për vlerësimin e dëmeve, ku me 16 janar ka raportuar në Qeveri për dëmet e shkaktuara në Komunën e Junikut, ku qeveria Hoti ka deleguar kompensimin e dëmeve në ministritë përkatëse varësisht nga dëmet në ekonomi familjare, infrastrukturë apo bujqësi, Komuna e Junikut ka raportuar sipas afatit të paraparë, mirpo deri më tani as qeveria Hoti, as kjo qeveri nuk i janë përgjigjur kompensimit të dëmeve, njoftoj që është takuar me Ministrin Aliu pikërisht për këtë qasje dhe është zotuar që do ta paraqes në mbledhjen e qeverisë.

z. Muharrem Krasniqi: A dëshiron dikush tjetër fjalën ?

z. Florim Shala: Rikujtoj përballjen në debatin “Jeta në Komuna”, ku u diskutua edhe impianti i ujërave të zeza dhe kërkoj qartësim se a është pranuar nga Komuna si projekt dhe si po menaxhohet.

z. Agron Kuçi: Projekti i impiantit ka qenë projekt i USAID, i cili projekt i është dorëzuar Hidrodrinit për menaxhim dhe sipas marrëveshjes do duhej të punësoheshin katër mirëmbajtës.

z. Tahir Isufaj: Pyeti nëse ka kontratë.

z. Hasan Krasniqi: Qartësoj se po të mos egzistonte një kontratë e tillë nuk do ishim përfitues të këtij projekti. Kemi kontratë me shkrim.

z. Agron Kuçi: Njoftoj që është kërkuar dhe inicuar për themelimin e një ndërmarrje publike për menaxhimin e ujërave, mbeturinave, impianteve, kolektorëve dhe varrezave nga tri qeveri mirpo një kërkesë e tillë nuk na është aprovuar.

z. Hasan Krasniqi: Në Planin Hapësinor të Kosovës është e planifikuar me u bë shtatë (7) impianta në shtatë (7) zona të Kosovës dhe në Planin Zhvillimor e kemi të përfshirë atë pjesë e kemi diskutuar dhe më përpara, për Junikun është shumë interes kur bëhet impiantit në Komunën e Gjakovës.

z. Florim Shala: Kërkoj nga Drejtori z. Hasan Krasniqi që në mbledhjen e ardhshme t’ia sjellë me shkrim që ka kontratë me Hidrodrinin.

z. Muharrem Krasniqi: E sjellë kopjen e kontratës.

z. Hasan Krasniqi: Tutje shtojë se japin përgjegjësi për çdo gjë që flasin qoftë me shkrim apo pa shkrim, jemi përgjegjës para jush dhe do e sjelli kopjen e kontratës.

z. Muharrem Krasniqi: Nëse nuk ka dikush tjetër, ju falenderojë për pjesëmarrje. Dhe e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi me punë në ora: 14:58.

Procesmbajtës:


znj. Fitore Velijaj

Kryesues i Kuvendit:

z. Muharrem Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK



**(PROJEKT) RREGULLORE
PËR MENAXHIMIN E VARREZAVE KOMUNALE**

Junik, 2021

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi, 12.2, pika c) të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) të nenit 12 parafi 12.2 dhe neni 21 paragrafi 21.1 pika j të Statutit të Komunës së Junikut 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e mbajtur më _____, miratoi këtë

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E VARREZAVE KOMUNALE NË KOMUNËN E JUNIKUT

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.
2. Rregullimi, mirëmbajtja e varrezave dhe varrimi, janë veprimtari komunale të interesit publik.

Neni 2 Përkufizimet

1. Me këtë rregullore termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - 1.1. "**Vend-varrezë**" nënkuptojmë varrin dhe varrezat familjare;
 - 1.2. "**Varr**" nënkuptojmë gropën e gërmuar në tokë për të futur të vdekurin (kufomën) ose mbetjet mortore;
 - 1.3. "**Varrezë**" nënkuptojmë vendin/hapësirën ku varrosen të vdekurit, e cila përfshinë anën e brendshme (hapësira për të futur të vdekurin dhe hapësira tjetër përcjellëse) dhe anën e jashtme e cila përfshinë (hapësira qarkulluese e parkimit dhe e shërbimeve tjera);
 - 1.4. "**Varrmihës**" nënkuptojmë punëtorin që hap varre në varreza;
 - 1.5. "**Varrim**" nënkuptojmë ceremoninë e përcjelljes të vdekurit për në varr;
 - 1.6. "**Varrhumbur**" nënkuptojmë humbjen e varrit që nuk dihet se ku është varrosur;
 - 1.7. "**Kufomë**" është trupi i njeriut, i privuar nga funksionet jetësore ;
 - 1.8. "**Shërbim i varrimit**" është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës;
 - 1.9. "**Zhvarrim**" është nxjerrja e kufomës dhe/ose mbetjeve mortore nga varri;
 - 1.10. "**Zhvarrim i zakonshëm**" është zhvarrimi që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes;
 - 1.11. "**MAPL**" është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
 - 1.12. "**DSHPIMSH**" është Drejtoria për Shërbimeve Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim;

- 1.13. "Ekshumimi" -zhvarrosje, nxjerrja e kufomës nga varri ;
- 1.14. "Zhvarrim i jashtëzakonshëm" është zhvarrimi që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsye transferimi në një varr tjetër, pas një periudhe të paracaktuar kohe ose për interes publik;
- 1.15. "Kohë e prehjes" është koha gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm i kufomës.

Neni 3 Varrezat

1. Në aspektin e hapësirës dallojmë këto varreza:
 - 1.1. varreza formale – varrezat e reja të qytetit (vendndodhja Rogopeq);
 - 1.2. varreza jo formale - varrezat e vjetra dhe
 - 1.3. varrezat e Heronjve, Dëshmorëve dhe Martirëve.
2. Hapësira e përcaktuar për varreza duhet të jetë e paraparë me planin zhvillimor të komunës ose me plan të veçantë në pajtim me planin zhvillimor të komunës.
3. Varrezat duhet t'i përmbushin nevojat për varrosjen e të vdekurve për tërë territorin e Komunës së Junikut.

Neni 4

1. Ndërtimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i varrezave ekzistuese përcaktohet me plan dhe programin për marrjen e masave për rregullimin e gjendjes në hapësirë.
2. Plani dhe programi përfshinë periudhën se paku 100 vjet për varreza të reja, kurse për zgjerimin e varrezave ekzistuese më së paku 30 vjet me mundësi të zgjerimit në etapa.
3. Varrezat ekzistuese mund të zgjerohen, nëse për to ekziston hapësira e paraparë me planin zhvillimor të komunës dhe nëse janë të siguruara edhe kushtet tjera të parapara me këtë rregullore dhe me ligjet në fuqi .

Neni 5

1. Sipas mënyrës së themelimit, respektivisht mënyrës së vdekjes, varrezat klasifikohen në të përgjithshme (publike) dhe të veçanta.
2. Në varreza të veçanta hyjnë: **varret e Heronjve, Dëshmorëve dhe Martirëve.**
3. Në varreza të veçanta gëzojnë të drejtën e prehjes: Heronjtë, Dëshmorët dhe Martirët.

Neni 6

1. Sipërfaqja e nevojshme neto për varr duhet të jetë 2.20 metra katror për banor.
2. Te përcaktimi i sipërfaqes për varr, duhet llogaritur bruto dhe neto sipërfaqen e varrit.
3. Sipërfaqja neto e varrit, përfshinë parcelën/vendin e varrit.
4. Sipërfaqja bruto e varrit, përfshin neto sipërfaqen e varrit të rritur edhe për distancën në mes varreve.

Neni 7

1. Varrezat duhet vendosur në një vend me sipërfaqe të mjaftueshme, i përshtatshëm sipas konfiguracionit dhe kushteve të lokacionit për varrosje.
2. Vendi i varrezave duhet të jenë jashtë vendbanimit ose afër vendbanimit me qasje në rrugë dykrahëshe dhe me shtegun (rrugicë e ngushtë) e ndarë për këmbësorë.
3. Hapësira për varreza duhet t'i përmbush këto kritere:
 - 3.1 Sipas pozitës së varrezave toka duhet të jetë e kulluar, me rreze dhe e qetë, të jenë larg rrjedhave nëntokësore dhe sipërfaqësore të ujërave, jashtë zonave të ujërave të mbrojtura, zonave të cilat vërshohen nga ujërat, zonave të mbrojtura natyrore dhe rajoneve malore.
 - 3.2 Varrezat e reja duhet të jenë së paku 50 m nga rruga automobilistike, respektivisht qendra të ndërtuara ose që do të ndërtohen, ndërtesa të dedikuara për çështje afariste.
 - 3.3 Tek zgjerimi i varrezave ekzistuese, largësia duke pasur parasysh pikën 3 të nenit 7, mund të jetë deri në 10 m, me kusht që për gjatë varrezave të sigurohet një shirit gjelbërues në gjerësi minimale prej 5 m i cili e përshkon tërë gjatësinë e objekteve kontaktuese.

Neni 8

1. Varrezat përbëhen prej:
 - 1.1 Vendi të varrit (vetë varri).
 - 1.2 Radhët e varrezave të cilën e përbëjnë një mori varresh (varret).
 - 1.3 Fushat e varrezave (disa rende të varreve por jo më tepër se 200 varre në një shteg).
 - 1.4 Shtegu i cili lidh grupet e varreve me fushën e varreve ose rendin e varreve.
 - 1.5 Shtigjet kryesore të cilat lidhin fushat e varreve, me pushimore dhe hapësirën për zgjerim.
 - 1.6 Rrugëve interne dhe eksterne (jashtme) për qarkullimin e automjeteve dhe parkimin.
 - 1.7 Gjelbërimet (grupore dhe përcjellëse).

- 1.8 Vendi ku bëhet përshëndetja e fundit lamtumirës, mund të jetë i mbyllur ose i hapur në përputhje me rregullat sipas përkatësisë fetare
- 1.9 Objektet tjera përcjellëse shërbyese për kufomën (hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare).
- 1.10 Parkingu për automjete.

Neni 9

1. Varri është gropa e varrit me proporcion sipas normave urbanistike:
 - 1.1. 1.00 x 0.60 m - deri në moshën 3 vjet;
 - 1.2. 1.50 x 0.60 m - 1.50 x 0.75 m prej moshës 4 vjet deri në moshën 10 vjet;
 - 1.3. 2.10 x 0.70 m - 2.50 x 1.20 m mbi 11 vjet.
2. Fundi i gropës së varrit sipas grupeve të përcaktuara në paragrafin 9.1 të kësaj rregulloreje, duhet të jetë më së paku 50 cm mbi nivelin e pikës më të lartë të ujërave nëntokësore.
3. Thellësia e varrit përcaktohet në bazë të rregullave sipas riteve fetare, e që nuk mund të jetë më e thellë se 180 cm.
4. Dimensionet e varrezave familjare janë 2.40 x 2.80 m, maksimalisht 4 varreza.
5. Mbulesa e varrit mbi kufomë, duhet të bëhet sipas riteve fetare, por jo më shumë se 0.80 m.
6. Lartësia e varrezave familjare dhe e përmendoreve mund të jetë më shumti deri në 2 m. Në të mund të shënohen atributet e personit të vdekur (emri, mbiemri, viti i lindjes, i vdekjes, fotografia dhe përkujtim i shkurtër).
7. Zbatimi i paragrafit 4 varet nga kushtet tekniko-urbanistike të lokacionit.

Neni 10

1. Varri mund të bëhet edhe me elemente të gatshme montuese, duke respektuar dimensionet sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje.
2. Varrezat duhet të jenë të renditura në atë mënyrë që rendet e varrezave të mos të jenë më të gjata se 60 m.
3. Fushat e varrezave përbëhen prej rendeve të varrezave dhe distancës ndërmjet tyre që shërben si shteg për me shkua deri te varri.
4. Fushat e varrezave duhet të jenë të ndara me shtigje kryesore me gjatësi minimale prej 3 m.
5. Shtigjet duhet të jenë të ndërtuara prej materialit të fortë pa pengesa për lëvizje dhe jo më të pjerrtë se 8% ndërsa tërthorazi jo më pjerrtë se 1%.

Neni 11

Me rastin e varrosjes, duhet të mbahet evidenca nga ana e organit kompetent (DSHPIMSH) respektivisht ndërmarrja publike ose ndërmarrjes tjetër e specializuar për këtë çështje të autorizuar.

Neni 12

1. Në pajtim me nenin 8 pika (9) të kësaj rregulloreje, objektet tjera përcjellëse shërbyese hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare), mund të jetë: me thupra metalike me bazament ose material tjetër bashkëkohor, ndërtohen në bazë të një plani të veçantë në pajtim me planin e përgjithshëm të varrezave.
2. Hapësira për qëndrimin e kufomës duhet të jetë e ndërtuar duke pasur parasysh rregullat e riteve fetare të komuniteteve.
3. Parku i automjeteve, duhet të jetë jashtë varrezave dhe i ndarë nga rruga publike.
4. Rrugët e këmbësorëve – shtigjet rregullohen si trotuare të pavarura për qasje deri te vend varrimi dhe të përshtatshme për kalim për personat me karrocë (hendikep).

Neni 13

Mirëmbajtja e varrezave

1. Organi kompetent i administratës (DSHPIMSH) administron me punët e varrimit, të rregullimit dhe mirëmbajtjes së varrezave në qytet dhe fshatra, nëse ndryshe nuk është e rregulluar me ligj.
2. Të gjitha varret dhe varrezat do të trajtohen me pietet dhe dinjitet nga komuna, duke respektuar të gjitha konfesionet fetare.
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, anëtarët e të gjitha feve do të kenë qasje të barabartë në ofrimin e shërbimeve komunale, sipas kushteve të parapara me këtë rregullore.

Neni 14

Punët e varrimit, të rregullimit dhe të mirëmbajtjes së varrezave në territorin e Komunës i kryen ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar për këtë qëllim.

Neni 15

1. Punët në vështrim të nenit 14 të kësaj rregulloreje rregullohen me kontratë administrative në pajtim me rregullat për prokurimin publik dhe shërbimeve publike.
2. Me leje të DSHPIIMSH-së, rregullimin e varrit mund ta bëj edhe anëtari i familjes së të vdekurit.

Neni 16

1. Mirëmbajtja e varrezave, në vështrim të kësaj rregulloreje përfshinë: objektet tjera përcjellëse shërbyese (hapësira për qëndrim të kufomës), ndriçimin publik, rrugët kalimtare, shtigjet, kroin për ujë, rrethojën e varrezave, parkun e automjeteve, stabilimentet sanitare, gjelbërimin, pastërtinë dhe rendin në varreza.
2. Mirëmbajtja (disa punë zejtare) në varr dhe varreza familjare mund të bëhen nga ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar për këtë çështje, përjashtimisht edhe nga vetë familjarët e të vdekurit në këto kushte:
 - 2.1. Të merret leja nga ana organit kompetent (DSHPIMSH) ose ndërmarrja publike e autorizuar;
 - 2.2. Koha e kryerjes së punëve duhet të jetë prej orës 7-18:00 në ditët e punës;
 - 2.3. Materiali ndërtimor (rëra, zhavorri, hekuri dhe materiali tjetër) lejohet të qëndrojë në varreza për kohë të shkurtër në mënyrë që të mos pengoj lëvizjen e vizitorëve në varreza dhe pas kryerjes së punëve duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme;
 - 2.4. Transporti i materialit, duhet të bëhet vetëm nëpër rrugë dhe shtigje që i cakton dhënësi i lejes;
 - 2.5. Gjatë punimeve nëse haset në ndonjë pjesë të arkivolit ose ndonjë ashtë (kockë) duhet të mbulohen në të njëjtin vend;
 - 2.6. Nëse gjatë punimeve gjinden sende me vlerë duhen t' i dorëzohen Organit kompetent (DSHPIMSH) ;
 - 2.7. Kroi, gjatë përdorimit duhet të përdoret me kujdes që mos t'ju shkaktohet dëmi varreve dhe varrezave tjera dhe;
 - 2.8. Për vendosjen e pllakave përkujtimore ose përmendoreve, duhet të paraqitet kërkesë e veçantë me skicën e objektit, respektivisht përmendores dhe vërtetimin se është siguruar shfrytëzimi i vendvarrimit.
3. Shpenzimet lidhur me kryerjen e punëve sipas paragrafit 2 të këtij neni bien në barrë të atij i cili bënë kërkesën për mirëmbajtje të varrit dhe varrezave familjare.

Neni 17

1. Planin e mirëmbajtjes së varrezave, kushtet dhe tarifat i cakton DSHPIIMSH-ja.

2. Tarifat për shërbimet e varrimit dhe lidhur me varrezat përcaktohen me rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba me propozim të DSHPIMSH - së.

Neni 18 Sjellja në varreza

1. Vizituesit e varrezave janë të detyruar që në varreza të sillen në mënyrën e cila i përgjigjet pietetit ndaj të vdekurve dhe me dinjitet në vendet ku ato prehen.
2. Varrezat nuk mund të vizitohen në çdo kohë përpos në kohën në të cilën lejohet vizita e varrezave e publikuar nga ana e DSHPIMSH - së në hyrje të varrezave.
3. Në varreza nuk mund të sillen fëmijët deri në moshën 10 vjeçare. Përgjatimisht me përcjelljen e prindërve, personave tjerë të moshuar ose kujdestarit të tij.

Neni 19

1. Në varreza ndalohet:

- 1.1. Shkatërrimi me qëllim i vendvarrimeve;
- 1.2. Shkelja dhe kapërcimi nëpër varre dhe varreza dhe shlyerja tyre;
- 1.3. Shkaktimi dëmit në varreza ose në shenjat tjera përkujtimore (në përmendore dhe objekte tjera përkujtimore në varreza);
- 1.4. Prishja e rendit në varreza;
- 1.5. Thyerja e rrethojave në varreza, dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, drunjtëve dhe bimëve tjera të mbjella në varreza;
- 1.6. Hyrja në hapësirën e varrezave me automjete private dhe mjete tjera tërheqëse pa pëlqim paraprak;
- 1.7. Futja e kafshëve;
- 1.8. Krijimi i papastërtisë në shtigjet dhe në sipërfaqet e gjelbëruara, vendosja ose hedhja e kurorave të vyshkura, luleve të vyshkura ose sendeve tjera ;
- 1.9. Fotografimi pa leje i varrezave për çështje profesionale dhe shpërndarja e fletëpalosjeve;
- 1.10. Sjellja dhe lënia pa leje e sendeve të ndryshme në varre dhe varreza që nuk kanë të bëjnë me varre dhe varreza;
- 1.11. Hyrja në objektin ku qëndron kufoma dhe objektet tjera jashtë kohës së përcaktuar për varrim, përjashtuar rastet me autorizim të veçantë;
- 1.12. Ndezja e qirinjve jashtë shtëpizave të parapara në varreza;
- 1.13. Qëndrimi i lypsarëve brenda dhe në hyrje të varrezave;
- 1.14. Hedhja e mbeturinave brenda në varreza dhe jashtë varrezave;
- 1.15. Ushtrimi i çdo lloj tregtie.
- 1.16. Pjesëmarrja në zhvarrimin e kufomave që nuk i përkasin familjes, përveç rasteve kur ka pëlqimin e palëve, që kanë të drejtë sipas autorizimit të veçantë .

Neni 20

DSHPIMSH-ja cakton rregullat e sjelljes në pajtim me nenin 17 të kësaj rregulloreje dhe duhet publikuar në vend të dukshëm në hyrje të varrezave.

Neni 21

Varrimi dhe veprimet tjera lidhur me varrimin

1. Varrimi bëhet në pajtim me dispozitat sanitare edhe sipas mënyrës që i përgjigjet pietetit ndaj të vdekurit, në sajë të nderimit të ndjenjave të farefisit dhe të personave tjerë të cilët kanë qenë në afërsi me të vdekurin.
2. Varrimi duhet të bëhet vetëm pasi të jetë vërtetuar vdekja në mënyrë të caktuar me dispozita të veçanta.
3. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet pasi që të kalojnë 12 orë pas vdekjes, përpos rasteve kur mjeku i autorizuar e jep mendimin se mund të bëhet varrimi i të vdekurit edhe para skadimit të këtij afati.
4. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet edhe në varrezat të cilat i ka caktuar i vdekuri për së gjalli, ose në varrezat që i zgjedhë familja e tij ose personat të cilët kujdesen për varrosjen e tij me kushtin që të merret leja nga Organi Kompetent i Komunës.

Neni 22

Lejen për varrimin e të vdekurit në varrezat e caktuara dhe për vendvarrim në qytet dhe fshat e jep DSHPIMSH-ja, në koordinim me zyrën e gjendjes civile në Komunë.

Neni 23

1. Bartja e kufomave bëhet me arkë për kufoma (arkivol).
2. Deri në aktin e varrosjes kufomat duhet të ruhen në lokale të caktuara për këtë qëllim.
3. Bartja e kufomave deri te varrezat bëhet sipas rregullave të riteve fetare të komuniteteve.

Neni 24

Bartjen e kufomave në territorin e komunës e bënë ndërmarrja publike e specializuar komunale ose ndërmarrja tjetër e specializuar e kontraktuar për këtë qëllim apo nga ana e vetë familjarëve.

Neni 25

Para varrimit, kufomat e personave të merituar, heronjve, dëshmorëve, martirëve dhe personave tjerë me merita të veçanta, mund të ekspozohet në vendin e caktuar jashtë varrezave me qëllim të dhënies së nderimit të veçantë të pasvdekjes, nëse organizimi i vdekjes bëhet nga organet komunale ose organet qendrore të shtetit.

Neni 26

Dhënia e nderimit të fundit (të pasvdekjes) mund të bëhet në hapësirën e përcaktuar në vend-varreza.

Neni 27

1. Me pëlqimin e organit kompetent komunal (DSHPIMSH) dhe inspeksionit sanitar në prani të policisë së Kosovës, mund të bëhet zhvarrosja (nxjerrja) e mbetjeve të kufomës për t'u bartur - rivarrosur në një vend-varrezë tjetër ose për çështje tjera (ekshumacionin e kufomave).
2. Lidhur me pikën 1 të këtij neni mbahet procesverbali nga ana e organit kompetent (DSHPIMSH) ose personit tjetër të autorizuar për këtë çështje dhe i nënshkruar nga palët.
3. Shpenzimet lidhur me punën rreth zhvendosjes dhe çështjeve tjera (ekshumacionin e kufomave) bien në barrë të vetë atij i cili ka kërkuar zhvendosjen e mbetjeve të kufomës ose për çështje tjera (ekshumacionin).

Neni 28

Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bënë organi kompetent për çështje të shërbimeve komunale (DSHPIMSH - ja) si dhe inspeksioni sanitar (përkatës).
2. Inspeksioni sanitar gjatë mbikëqyrjes mund të merr masa dhe të urdhërojë marrjen ose mos marrjen e një veprimi të caktuar, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e aplikueshme të ligjit.
3. Në vendimin e inspeksionit mund të ushtrohet ankesa në afatin prej 30 ditësh nga dita e njoftimit, drejtuar Kryetarit të Komunës.

Dispozitat ndëshkimore

Neni 29

1. Për shkelje të nenit 16 paragrafi 2, nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafët 1 - 16 dënohen për kundërvajtje me gjobë:
 - 1.1. Për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik në shumën prej 10€ - 100€;
 - 1.2. Për personin fizik që ushtron biznes individual prej 30€ - 250€;
 - 1.3. Për personin juridik prej 100€ - 1500€.
2. Për shkelje të nenit 10 paragrafi 2,3,4 dhe 5 dënohen për kundërvajtje me gjobë:
 - 2.1. Për personin fizik që ushtron biznes individual prej 30€ - 250€,
 - 2.2. Për personin përgjegjës të personit juridik, 10€ - 100€, dhe
 - 2.3. Për personin juridik, dënohet 100€ - 1500€.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 30.

1. Çdo dispozitë e kësaj rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi epërsi do të kenë dispozitat ligjore.

Neni 31

Kjo rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut


_____, dt. _____
Nr. _____

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 3-180/3343
Nr. i faq. 14105
Data 2021



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	14.05.2021
REFERENC-Ë:	03/07/2021
PËR/ZA/TO:	z. Muharrem Krasniqi – Kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Agron Kuçi – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj. Leonita Jasiqi – Drejtore e Administratës së Përgjithshme
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për shqyrtim dhe miratim (Projekt) Rregullores për Menaxhimin e Varrezave Komunale, (Leximi i parë)

I Nderuar zotëri Krasniqi!

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 12, paragrafi 12.2, pika c), neni 40, paragrafi 40.2, pika a), Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.28/15, Qershor 2008, nenin 21, paragrafi 21.1, pika d) dhe nenit 22, paragrafi 22.1, pika 3 të Statutit të Komunës së Junikut Nr. 001/3127, të datës 29.09.2010, Vendimin Nr.002/11 të Kuvendit Komunal dhe Vendimin e Kryetarit të Komunës së Junikut Nr.01/83, kërkojmë që të shqyrtohet dhe miratohet (Projekt) Rregullorja për Menaxhimin e Varrezave Komunale.

Bashkëngjitur gjeni: (Projekt) Rregulloren për Menaxhimin e Varrezave Komunale.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



**(PROJEKT) RREGULLORE
PËR MENAXHIMIN E VARREZAVE KOMUNALE**

Junik, 2021

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi, 12.2, pika c) të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) të nenit 12 parafi 12.2 dhe neni 21 paragrafi 21.1 pika j të Statutit të Komunës së Junikut 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e mbajtur më _____, miratoi këtë

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E VARREZAVE KOMUNALE NË KOMUNËN E JUNIKUT

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.
2. Rregullimi, mirëmbajtja e varrezave dhe varrimi, janë veprimtari komunale të interesit publik.

Neni 2 Përkufizimet

1. Me këtë rregullore termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - 1.1. "Vend-varrezë" nënkuptojmë varrin dhe varrezat familjare;
 - 1.2. "Varr" nënkuptojmë gropën e gërmuar në tokë për të futur të vdekurin (kufomën) ose mbetjet mortore;
 - 1.3. "Varrezë" nënkuptojmë vendin/hapësirën ku varrosen të vdekurit, e cila përfshinë anën e brendshme (hapësira për të futur të vdekurin dhe hapësira tjetër përcjellëse) dhe anën e jashtme e cila përfshinë (hapësira qarkulluese e parkimit dhe e shërbimeve tjera);
 - 1.4. "Varrmihës" nënkuptojmë punëtorin që hap varre në varreza;
 - 1.5. "Varrim" nënkuptojmë ceremoninë e përcjelljes të vdekurit për në varr;
 - 1.6. "Varrhumbur" nënkuptojmë humbjen e varrit që nuk dihet se ku është varrosur;
 - 1.7. "Kufomë" është trupi i njeriut, i privuar nga funksionet jetësore ;
 - 1.8. "Shërbim i varrimit" është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës;
 - 1.9. "Zhvarrim" është nxjerrja e kufomës dhe/ose mbetjeve mortore nga varri;
 - 1.10. "Zhvarrim i zakonshëm" është zhvarrimi që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes;
 - 1.11. "MAPL" është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
 - 1.12. "DSHPIMSH" është Drejtoria për Shërbimeve Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim;

1.13. "Ekshumimi" -zhvarrosje, nxjerrja e kufomës nga varri ;

1.14. "Zhvarrim i jashtëzakonshëm" është zhvarrimi që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsye transferimi në një varr tjetër, pas një periudhe të paracaktuar kohe ose për interes publik;

1.15. "Kohë e prehjes" është koha gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm i kufomës.

Neni 3 Varrezat

1. Në aspektin e hapësirës dallojmë këto varreza:

1.1. varreza formale – varrezat e reja të qytetit (vendndodhja Rogopeq);

1.2. varreza jo formale - varrezat e vjetra dhe

1.3. varrezat e Heronjve, Dëshmorëve dhe Martirëve.

2. Hapësira e përcaktuar për varreza duhet të jetë e paraparë me planin zhvillimor të komunës ose me plan të veçantë në pajtim me planin zhvillimor të komunës.

3. Varrezat duhet t'i përmbushin nevojat për varrosjen e të vdekurve për tërë territorin e Komunës së Junikut.

Neni 4

1. Ndërtimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i varrezave ekzistuese përcaktohet me plan dhe programin për marrjen e masave për rregullimin e gjendjes në hapësirë.

2. Plani dhe programi përfshinë periudhën se paku 100 vjet për varreza të reja, kurse për zgjerimin e varrezave ekzistuese më së paku 30 vjet me mundësi të zgjerimit në etapa.

3. Varrezat ekzistuese mund të zgjerohen, nëse për to ekziston hapësira e paraparë me planin zhvillimor të komunës dhe nëse janë të siguruara edhe kushtet tjera të parapara me këtë rregullore dhe me ligjet në fuqi.

Neni 5

1. Sipas mënyrës së themelimit, respektivisht mënyrës së vdekjes, varrezat klasifikohen në të përgjithshme (publike) dhe të veçanta.

2. Në varreza të veçanta hyjnë: varret e Heronjve, Dëshmorëve dhe Martirëve.

3. Në varreza të veçanta gëzojnë të drejtën e prehjes: Heronjtë, Dëshmorët dhe Martirët.

Neni 6

1. Sipërfaqja e nevojshme neto për varr duhet të jetë 2.20 metra katror për banor.
2. Te përcaktimi i sipërfaqes për varr, duhet llogaritur bruto dhe neto sipërfaqen e varrit.
3. Sipërfaqja neto e varrit, përfshinë parcelën/ vendin e varrit.
4. Sipërfaqja bruto e varrit, përfshin neto sipërfaqen e varrit të rritur edhe për distancën në mes varreve.

Neni 7

1. Varrezat duhet vendosur në një vend me sipërfaqe të mjaftueshme, i përshtatshëm sipas konfiguracionit dhe kushteve të lokacionit për varrosje.
2. Vendi i varrezave duhet të jenë jashtë vendbanimit ose afër vendbanimit me qasje në rrugë dykrahëshe dhe me shtegun (rrugicë e ngushtë) e ndarë për këmbësorë.
3. Hapësira për varreza duhet t'i përmbush këto kriterë:
 - 3.1 Sipas pozitës së varrezave tok duhet të jetë e kulluar, me rreze dhe e qetë, të jenë larg rrjedhave nëntokësore dhe sipërfaqësore të ujërave, jashtë zonave të ujërave të mbrojtura, zonave të cilat vërshohen nga ujërat, zonave të mbrojtura natyrore dhe rajoneve malore.
 - 3.2 Varrezat e reja duhet të jenë së paku 50 m nga rruga automobilistike, respektivisht qendra të ndërtuara ose që do të ndërtohen, ndërtesa të dedikuara për çështje afariste.
 - 3.3 Tek zgjerimi i varrezave ekzistuese, largësia duke pasur parasysh pikën 3 të nenit 7, mund të jetë deri në 10 m, me kusht që për gjatë varrezave të sigurohet një shirit gjelbërues në gjerësi minimale prej 5 m i cili e përshkon tërë gjatësinë e objekteve kontaktuese.

Neni 8

1. Varrezat përbëhen prej:
 - 1.1 Vendi të varrit (vetë varri).
 - 1.2 Radhët e varrezave të cilën e përbëjnë një mori varresh (varret).
 - 1.3 Fushat e varrezave (disa rende të varreve por jo më tepër se 200 varre në një shteg).
 - 1.4 Shtegu i cili lidh grupet e varreve me fushën e varreve ose rendin e varreve.
 - 1.5 Shtigjet kryesore të cilat lidhin fushat e varreve, me pushimore dhe hapësirën për zgjerim.
 - 1.6 Rrugëve interne dhe eksterne (jashtme) për qarkullimin e automjeteve dhe parkimin.
 - 1.7 Gjelbërimet (grupore dhe përcjellëse).

- 1.8 Vendi ku bëhet përshëndetja e fundit lamtumirës, mund të jetë i mbyllur ose i hapur në përputhje me rregullat sipas përkatësisë fetare
- 1.9 Objektet tjera përcjellëse shërbyese për kufomën (hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare).
- 1.10 Parkingu për automjete.

Neni 9

1. Varri është gropa e varrit me proporcion sipas normave urbanistike:
 - 1.1. 1.00 x 0.60 m - deri në moshën 3 vjet;
 - 1.2. 1.50 x 0.60 m – 1.50 x 0.75 m prej moshës 4 vjet deri në moshën 10 vjet;
 - 1.3. 2.10 x 0.70 m – 2.50 x 1.20 m mbi 11 vjet.
2. Fundi i gropës së varrit sipas grupeve të përcaktuara në paragrafin 9.1 të kësaj rregulloreje, duhet të jetë më së paku 50 cm mbi nivelin e pikës më të lartë të ujërave nëntokësore.
3. Thellësia e varrit përcaktohet në bazë të rregullave sipas riteve fetare, e që nuk mund të jetë më e thellë se 180 cm.

Dimensionet e varrezave familjare janë 2.40 x 2.80 m, maksimalisht 4 varreza.

5. Mbulesa e varrit mbi kufomë, duhet të bëhet sipas riteve fetare, por jo më shumë se 0.80 m.
6. Lartësia e varrezave familjare dhe e përmendoreve mund të jetë më shumë deri në 2 m. Në të mund të shënohen atributet e personit të vdekur (emri, mbiemri, viti i lindjes, i vdekjes, fotografia dhe përkujtim i shkurtër).
7. Zbatimi i paragrafit 4 varet nga kushtet tekniko-urbanistike të lokacionit.

Neni 10

1. Varri mund të bëhet edhe me elemente të gatshme montuese, duke respektuar dimensionet sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje.
2. Varrezat duhet të jenë të renditura në atë mënyrë që rendet e varrezave të mos të jenë më të gjata se 60 m.
3. Fushat e varrezave përbëhen prej rendeve të varrezave dhe distancës ndërmjet tyre që shërben si shteg për me shkua deri te varri.
4. Fushat e varrezave duhet të jenë të ndara me shtigje kryesore me gjatësi minimale prej 3 m.
5. Shtigjet duhet të jenë të ndërtuara prej materialit të fortë pa pengesa për lëvizje dhe jo më të pjerrtë se 8% ndërsa tërthorazi jo më pjerrtë se 1%.

Neni 11

Me rastin e varrosjes, duhet të mbahet evidenca nga ana e organit kompetent (DSHPIMSH) respektivisht ndërmarrja publike ose ndërmarrjes tjetër e specializuar për këtë çështje të autorizuar.

Neni 12

1. Në pajtim me nenin 8 pika (9) të kësaj rregulloreje, objektet tjera përcjellëse shërbyese hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare), mund të jetë: me thupra metalike me bazament ose material tjetër bashkëkohor, ndërtohen në bazë të një plani të veçantë në pajtim me planin e përgjithshëm të varrezave.
2. Hapësira për qëndrimin e kufomës duhet të jetë e ndërtuar duke pasur parasysh rregullat e rriteve fetare të komuniteteve.
3. Parku i automjeteve, duhet të jetë jashtë varrezave dhe i ndarë nga rruga publike.
4. Rrugët e këmbësorëve – shtigjet rregullohen si trotuare të pavarura për qasje deri te vend varrimi dhe të përshtatshme për kalim për personat me karrocë (hendikep).

Neni 13

Mirëmbajtja e varrezave

1. Organi kompetent i administratës (DSHPIMSH) administron me punët e varrimit, të rregullimit dhe mirëmbajtjes së varrezave në qytet dhe fshatra, nëse ndryshe nuk është e rregulluar me ligj.
2. Të gjitha varret dhe varrezat do të trajtohen me pietet dhe dinjitet nga komuna, duke respektuar të gjitha konfesionet fetare.
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, anëtarët e të gjitha feve do të kenë qasje të barabartë në ofrimin e shërbimeve komunale, sipas kushteve të parapara me këtë rregullore.

Neni 14

Punët e varrimit, të rregullimit dhe të mirëmbajtjes së varrezave në territorin e Komunës i kryen ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar për këtë qëllim.

Neni 15

1. Punët në vështrim të nenit 14 të kësaj rregulloreje rregullohen me kontratë administrative në pajtim me rregullat për prokurimin publik dhe shërbimeve publike.
2. Me leje të DSHPIMSH-së, rregullimin e varrit mund ta bëj edhe anëtari i familjes së të vdekurit.

Neni 16

1. Mirëmbajtja e varrezave, në vështrim të kësaj rregulloreje përfshinë: objektet tjera përcjellëse shërbyese (hapësira për qëndrim të kufomës), ndriçimin publik, rrugët kalimtare, shtigjet, kroin për ujë, rrethojën e varrezave, parkun e automjeteve, stabilimentet sanitare, gjelbërimin, pastërtinë dhe rendin në varreza.
2. Mirëmbajtja (disa punë zejtare) në varr dhe varreza familjare mund të bëhen nga ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar për këtë çështje, përjashtimisht edhe nga vetë familjarët e të vdekurit në këto kushte:
 - 2.1. Të merret leja nga ana organit kompetent (DSHPIMSH) ose ndërmarrja publike e autorizuar;
 - 2.2. Koha e kryerjes së punëve duhet të jetë prej orës 7-18:00 në ditët e punës;
 - 2.3. Materiali ndërtimor (rëra, zhavorri, hekuri dhe materiali tjetër) lejohet të qëndrojë në varreza për kohë të shkurtër në mënyrë që të mos pengoj lëvizjen e vizitorëve në varreza dhe pas kryerjes së punëve duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme;
 - 2.4. Transporti i materialit, duhet të bëhet vetëm nëpër rrugë dhe shtigje që i cakton dhënësi i lejes;
 - 2.5. Gjatë punimeve nëse haset në ndonjë pjesë të arkivolit ose ndonjë ashtë (kockë) duhet të mbulohen në të njëjtin vend;
 - 2.6. Nëse gjatë punimeve gjinden sende me vlerë duhen t' i dorëzohen Organit kompetent (DSHPIMSH) ;
 - 2.7. Kroi, gjatë përdorimit duhet të përdoret me kujdes që mos t'ju shkaktohet dëmi varreve dhe varrezave tjera dhe;
 - 2.8. Për vendosjen e pllakave përkujtimore ose përmendoreve, duhet të paraqitet kërkesë e veçantë me skicën e objektit, respektivisht përmendores dhe vërtetimin se është siguruar shfrytëzimi i vendvarrimit.
3. Shpenzimet lidhur me kryerjen e punëve sipas paragrafit 2 të këtij neni bien në barrë të atij i cili bënë kërkesën për mirëmbajtje të varrit dhe varrezave familjare.

Neni 17

1. Planin e mirëmbajtjes së varrezave, kushtet dhe tarifat i cakton DSHPIMSH-ja.

2. Tarifat për shërbimet e varrimit dhe lidhur me varrezat përcaktohen me rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba me propozim të DSHPIMSH - së.

Neni 18 Sjellja në varreza

1. Vizituesit e varrezave janë të detyruar që në varreza të sillen në mënyrën e cila i përgjigjet pietetit ndaj të vdekurve dhe me dinjitet në vendet ku ato prehen.
2. Varrezat nuk mund të vizitohen në çdo kohë përpos në kohën në të cilën lejohet vizita e varrezave e publikuar nga ana e DSHPIMSH - së në hyrje të varrezave.
3. Në varreza nuk mund të sillen fëmijët deri në moshën 10 vjeçare. Përgjashtimisht me përcjelljen e prindërve, personave tjerë të moshuar ose kujdestarit të tij.

Neni 19

1. Në varreza ndalohet:

- 1.1. Shkatërrimi me qëllim i vendvarrimeve;
- 1.2. Shkelja dhe kapërcimi nëpër varre dhe varreza dhe shlyerja tyre;
- 1.3. Shkaktimi dëmit në varreza ose në shenjat tjera përkujtimore (në përmendore dhe objekte tjera përkujtimore në varreza);
- 1.4. Prishja e rendit në varreza;
- 1.5. Thyerja e rrethojave në varreza, dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, drunjtëve dhe bimëve tjera të mbjella në varreza;
- 1.6. Hyrja në hapësirën e varrezave me automjete private dhe mjete tjera tërheqëse pa pëlqim paraprak;
- 1.7. Futja e kafshëve;
- 1.8. Krijimi i papastërtisë në shtigjet dhe në sipërfaqet e gjelbëruara, vendosja ose hedhja e kurorave të vyshkura, luleve të vyshkura ose sendeve tjera ;
- 1.9. Fotografimi pa leje i varrezave për çështje profesionale dhe shpërndarja e fletëpalosjeve;
- 1.10. Sjellja dhe lënia pa leje e sendeve të ndryshme në varre dhe varreza që nuk kanë të bëjnë me varre dhe varreza;
- 1.11. Hyrja në objektin ku qëndron kufoma dhe objektet tjera jashtë kohës së përcaktuar për varrim, përjashtuar rastet me autorizim të veçantë;
- 1.12. Ndezja e qirinjve jashtë shtëpizave të parapara në varreza;
- 1.13. Qëndrimi i lypsarëve brenda dhe në hyrje të varrezave;
- 1.14. Hedhja e mbeturinave brenda në varreza dhe jashtë varrezave;
- 1.15. Ushtrimi i çdo lloj tregtie.
- 1.16. Pjesëmarrja në zhvarrimin e kufomave që nuk i përkasin familjes, përveç rasteve kur ka pëlqimin e palëve, që kanë të drejtë sipas autorizimit të veçantë .

Neni 20

DSHPIMSH-ja cakton rregullat e sjelljes në pajtim me nenin 17 të kësaj rregulloreje dhe duhet publikuar në vend të dukshëm në hyrje të varrezave.

Neni 21

Varrimi dhe veprimet tjera lidhur me varrimin

1. Varrimi bëhet në pajtim me dispozitat sanitare edhe sipas mënyrës që i përgjigjet pietetit ndaj të vdekurit, në saje të nderimit të ndjenjave të farefisit dhe të personave tjerë të cilët kanë qenë në afërsi me të vdekurin.
2. Varrimi duhet të bëhet vetëm pasi të jetë vërtetuar vdekja në mënyrë të caktuar me dispozita të veçanta.
3. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet pasi që të kalojnë 12 orë pas vdekjes, përpos rasteve kur mjeku i autorizuar e jep mendimin se mund të bëhet varrimi i të vdekurit edhe para skadimit të këtij afati.
4. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet edhe në varrezat të cilat i ka caktuar i vdekuri për së gjalli, ose në varrezat që i zgjedhë familja e tij ose personat të cilët kujdesen për varrosjen e tij me kushtin që të merret leja nga Organi Kompetent i Komunës.

Neni 22

Lejen për varrimin e të vdekurit në varrezat e caktuara dhe për vendvarrim në qytet dhe fshat e jep DSHPIIMSH-ja, në koordinim me zyrën e gjendjes civile në Komunë.

Neni 23

1. Bartja e kufomave bëhet me arkë për kufoma (arkivol).
2. Deri në aktin e varrosjes kufomat duhet të ruhen në lokale të caktuara për këtë qëllim.
3. Bartja e kufomave deri te varrezat bëhet sipas rregullave të rriteve fetare të komuniteteve.

Neni 24

Bartjen e kufomave në territorin e komunës e bënë ndërmarrja publike e specializuar komunale ose ndërmarrja tjetër e specializuar e kontraktuar për këtë qëllim apo nga ana e vetë familjarëve.

Neni 25

Para varrimit, kufomat e personave të merituar, heronjve, dëshmorëve, martirëve dhe personave tjerë me merita të veçanta, mund të ekspozohet në vendin e caktuar jashtë varrezave me qëllim të dhënies së nderimit të veçantë të pasvdekjes, nëse organizimi i vdekjes bëhet nga organet komunale ose organet qendrore të shtetit.

Neni 26

Dhënia e nderimit të fundit (të pasvdekjes) mund të bëhet në hapësirën e përcaktuar në vend-varreza.

Neni 27

1. Me pëlqimin e organit kompetent komunal (DSHPIMSH) dhe inspeksionit sanitar në prani të policisë së Kosovës, mund të bëhet zhvarrosja (nxjerrja) e mbetjeve të kufomës për t'u bartur - rivarrosur në një vend-varrezë tjetër ose për çështje tjera (ekshumacionin e kufomave).
2. Lidhur me pikën 1 të këtij neni mbahet procesverbali nga ana e organit kompetent (DSHPIMSH) ose personit tjetër të autorizuar për këtë çështje dhe i nënshkruar nga palët.
3. Shpenzimet lidhur me punën rreth zhvendosjes dhe çështjeve tjera (ekshumacionin e kufomave) bien në barrë të vetë atij i cili ka kërkuar zhvendosjen e mbetjeve të kufomës ose për çështje tjera (ekshumacionin).

Neni 28 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bënë organi kompetent për çështje të shërbimeve komunale (DSHPIMSH - ja) si dhe inspeksioni sanitar (përkatës).
2. Inspeksioni sanitar gjatë mbikëqyrjes mund të merr masa dhe të urdhërojë marrjen ose mos marrjen e një veprimi të caktuar, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e aplikueshme të ligjit.
3. Në vendimin e inspeksionit mund të ushtrohet ankesa në afatin prej 30 ditësh nga dita e njoftimit, drejtuar Kryetarit të Komunës.

Dispozitat ndëshkimore

Neni 29

1. Për shkelje të nenit 16 paragrafi 2, nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafët 1 - 16 dënohen për kundërvajtje me gjobë:
 - 1.1. Për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik në shumën prej 10€ - 100€;
 - 1.2. Për personin fizik që ushtron biznes individual prej 30€ - 250€;
 - 1.3. Për personin juridik prej 100€ - 1500€.
2. Për shkelje të nenit 10 paragrafi 2,3,4 dhe 5 dënohen për kundërvajtje me gjobë:
 - 2.1. Për personin fizik që ushtron biznes individual prej 30€ - 250€,
 - 2.2. Për personin përgjegjës të personit juridik, 10€ - 100€, dhe
 - 2.3. Për personin juridik, dënohet 100€ - 1500€.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 30.

1. Çdo dispozitë e kësaj rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi epërsi do të kenë dispozitat ligjore.

Neni 31

Kjo rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut

_____, dt. _____
Nr. _____

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

(Projekt)

**Rregullorja për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat,
Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet në Komunën e
Junikut**

Junik 2021

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. L-03-040, Nenit 7.1, Nenit 12.2.c, Nenit 40.2.h, Statutit të Komunës së Junikut, Nenit 7.2, Nenit 21.1.k dhe Vendimin Nr. 02/74 të Kuvendit Komunal të datës 30.04.2021, për plotësim ndryshimin e Rregullores për Simbole, Tituj të Nderit, Dekorata, Medalje, Mirënjohje dhe Falënderime në Komunën e Junikut, Kuvendi Komunal në Junik, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 00.00.2021, miraton:

Rregullore për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet në Komunën e Junikut

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është themelimi i bazës juridike dhe përcaktimi i llojit të Simboleve, Titujve të Nderit, Dekoratave, Medaljeve, Mirënjohjeve dhe Falënderimeve, i dhënies së tyre dhe revokimit të tyre nga Kuvendi i Komunës së Junikut, për qytetarët e Republikës së Kosovës, personat juridik, qytetarët e huaj dhe organizatat e ndryshme që shquhen për merita të veçanta ndaj Komunës së Junikut dhe interesave të saj.

NENI 2

Procedurat, Kriteret dhe kushtet për caktimin dhe rregullimin e simboleve komunale

2.1. Kuvendi Komunal miraton dhe ndryshon simbolet komunale siç janë: Stemat, Vulat, Emblemat dhe Flamujt komunal në përputhje me dispozitat kushtetuese, të ligjeve përkatëse, të Statutit të Komunës dhe të kësaj Rregulloreje.

NENI 3

Ndarja e Titujve, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera

3.1. Kuvendi Komunal në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet e tjera nënligjore si dhe me dispozitat tjera të kësaj Rregulloreje përcakton kushtet dhe kriteret e ndarjes së titujve të Nderit, Çmimeve dhe Shpërblimeve tjera.

3.2. Titujt e Nderit si dhe të gjitha shpërblimet tjera ndahen dhe jepen për kontribute të veçanta që kanë dhënë personalitetet e shquara dhe subjektet e tjera juridike, në lëmenjtë e humanizmit, sakrificës, kulturës, sportit dhe aktivitete të tjera në Komunën e Junikut dhe më gjerë.

3.3. Simbolet e Komunës së Junikut janë të rregulluara edhe me dispozitën e nenit 7 pika 7.2 të Statutit të Komunës.

3.4. Titujt, çmimet dhe shpërblimet tjera sipas kësaj rregulloreje janë:

3.4.1. Titulli "Kuvendi i Junikut"

3.4.2. Titulli "Qytetar Nderi",

- 3.4.3. Titulli "Nderi i Junikut",
- 3.4.4. Titulli "Dëshmorët e Junikut",
- 3.4.5. Titulli "Martiret e Junikut",
- 3.4.6. Çmimi "Din Mehmeti",
- 3.4.7. Medalja "Sportisti i Vitit",
- 3.4.8. Mirënjohje dhe Falënderime.

3.5. Përveç titujve, çmimeve, medaljeve dhe falënderimeve të lartë cekura në paragrafin 3.4 të këtij Neni, ndahen edhe: Dekorata, Pllaketa dhe shpërblime të tjera adekuate.

3.6. Ne raste të caktuara mund të ndahen edhe tituj postmortum (pas vdekjes) për personalitete të ndryshme.

3.7. Titujt i ndahen vetëm njëherë një personaliteti të caktuar.

3.8. Titujt dhe çmimet ndahen sipas dispozitave të kësaj rregulloreje nga Neni 4 deri në Nenin 10.

NENI 4 TITULLI "KUVENDI I JUNIKUT"

4.1. Titulli "Kuvendi i Junikut", është titulli i parë dhe më i lartë në Komunën e Junikut.

4.2. Titulli "Kuvendi i Junikut", i ndahet personaliteteve dhe institucioneve të veçanta, të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë në zhvillimin proceseve historike kombëtare, vlerave demokratike dhe universale.

4.3. Titulli "Kuvendi i Junikut", do të jetë titull tradicional, i cili do të ndahet në përvjetorët Jubilare, dhe do të jepet nga Kryetari i Komunës pas miratimit nga Kuvendi Komunal.

4.4. Titulli përbëhet nga një "Pllaketë Bronzi", që është e punuar në bronz, e praruar në ar, në sfond ka Simbolin e Kullës, sipër me shqiponjën dykrenare e rrethuar me dymbëdhjetë plisa të bardhë, si dhe një certifikatë solemne, të shkruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare të atyre që u jepet.

4.5. Pllaketa ka dimensionet 12 cm, në formë rrethi, në të cilën shkruhet titulli "Kuvendi i Junikut"

4.6. Titullin pas ndarjes nga Kuvendi Komunal e jep Kryetari i Komunës në eventet solemne të Kuvendit të Komunës sipas procedurave të parapara me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

4.7. Propozimin për ndarjen e këtij titulli mund ta japë Kryetari i Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe së paku 1/3 e Këshilltarëve të Kuvendit Komunal.

Iniciativën për dhënien e këtij titulli mund ta japë cildo institucion i Komunës, ose së paku 300 qytetarë të Komunës së Junikut.

4.8. Iniciativa dhe propozimet nga pika 4.7 i dorëzohen për procedim të mëtejshëm komisionit të

zgjedhur në Kuvendin Komunal, i cili vepron sipas procedurave të parapara me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

NENI 5 TITULLI "QYTETAR NDERI"

5.1. Titulli "Qytetar Nderi", është titull i lartë që u jepet personaliteteve të larta politike, shoqërore, shkencëtarëve, artistëve, të huajve që vizitojnë Komunën e Junikut, në shenjë respekti, miqësie apo mirënjohje për kontribute të rëndësishme e të veçanta në fusha të ndryshme në të mirë të qytetarëve. Po ashtu, ky titull u jepet personaliteteve të ndryshme, të cilat në kohët më të vështira ndihmuan rrugëtimin e popullit të Kosovës dhe Luftën e Ushtrisë Çlirimtare për Liri dhe Pavarësi.

5.2. Titulli përbëhet nga një "Pllaketë Bronzi", që është e punuar në bronz, e praruar në ar dhe e cila në sfond ka Emblemën e Kuvendit të Junikut 1912 si dhe një certifikatë solemne, të shkruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare të atij që i jepet.

5.3. Pllaketa ka dimensione 21x29.7 cm, emrin dhe mbiemrin e bartësit të shpërblimit, të shkruara me shkronja të gravura në radhën e parë dhe teksti "Qytetar Nderi i Junikut" në radhën e dytë.

5.4. Certifikata shkruhet në letër të fortë cilësore së paku 150 gr, formati A4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës është Emblema e Komunës së Junikut.

Në pjesën e sipërme të certifikatës shkruan: " Në bazë të nenit ____ të Statutit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut, në seancën e vetë solemne, të mbajtur më _____ (lihet vendi për datë), lëshon këtë Certifikatë " (në kryerresht, në mes, me shkronja solemne).

Pastaj, në kryerresht shkruhet: " Z. (emri dhe mbiemri i fituesit të shpërblimit, vendbanimi, komuna dhe shteti), është Qytetar Nderi i Komunës së Juniku, me të gjitha obligimet dhe privilegjet që ky shpërblim parasheh ". Në kryerresht shkruhet numri i protokollit të certifikatës dhe data, ndërsa nën të shkruhet: "Kuvendi i Komunës së Junikut". Një radhë më poshtë, në anën e djathtë të certifikatës shkruhet emri, mbiemri dhe nënshkrimi i Kryetarit të Komunës, kurse në anën e majtë shkruhet emri, mbiemri dhe nënshkrimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe në mes vula e Komunës.

5.5. Kuvendi i Komunës faktin e ndarjes së titullit e evidenton në regjistrin e veçantë të Qytetarëve të Nderit të Komunës së Junikut, të cilin e mban Kryetari i Komunës së Junikut.

5.6. Titullin pas ndarjes nga Kuvendi Komunal e jep Kryetari i Komunës në eventet solemne të Kuvendit të Komunës sipas procedurave të parapara me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

5.7. Propozimin për ndarjen e këtij titulli mund ta japë Kryetari i Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe së paku 1/3 e Këshilltarëve të Kuvendit Komunal.

Iniciativën për dhënien e këtij titulli mund ta japë cildo institucion i Komunës, ose së paku 300 qytetarë të Komunës së Junikut.

5.8. Iniciativa dhe propozimet nga pika 5.7 i dorëzohen për procedim të mëtejshëm komisionit të zgjedhur në Kuvendin Komunal, i cili vepron sipas procedurave të parapara me dispozitat e

kësaj Rregulloreje.

NENI 6 TITULLI "NDERI I JUNIKUT"

6.1. Titulli "Nderi i Junikut", është titull që u jepet personaliteteve të shquara të Komunës së Junikut që kanë dhënë kontribute të veçanta dhe tepër të rëndësishme, të cilët kanë lartësuar emrin e Junikut, që kanë një veprimtari të gjerë dhe të rëndësishme në dobi të qytetarëve, vlera të veçanta dhe shumë të njohura në rrafshin kombëtar, që janë personalitete të rëndësishme në fusha të veçanta të shoqërisë, shkencës, artit dhe sportit, që kanë formuar një figurë të pastër dhe që kanë cilësi të larta njerëzore.

6.2. Ky titull u ndahet atyre qytetarëve që realizojnë akte të larta humanizmi, heroizmi dhe sakrifica sublime.

6.3. Titulli përbëhet nga Plaketa dhe fletë mirënjohja.

6.4. Plaketa ka formë të rrumbullakët, është e punuar në bronz, e praruar në ar, me diametër 12 cm, në mesin e së cilës gjendet një kullë tradicionale Junikase, me emërtimin "Nderi i Junikut".

6.5. Fletë Mirënjohja përbëhet nga një fletë e kualitetit të lartë, të dimensionit A4, 150 gramësh dhe në tërë sfondin e fletës është emblema e Komunës, kurse në pjesën e sipërme të saj shkruhet: Kuvendi i Komunës së Junikut, numri dhe data e dhënies së titullit. Në mesin e fletës shkruan: Titulli "Nderi i Junikut", me emrin dhe mbiemrin e fituesit, nën të motivacioni i dhënies së saj. Një radhë më poshtë, në anën e djathtë të certifikatës, shkruhet emri, mbiemri dhe nënshkrimi Kryetarit të Komunës, në anën e majtë shkruhet emri, mbiemri dhe nënshkrimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe në mes vula e Komunës.

6.6. Propozimet për dhënien e këtij titulli të lartë duhet të bëhen nga institucione të rëndësishme të qeverisjes vendore, së bashku me shoqata dhe grupe qytetarësh, duke mundur një konsensus të gjerë e të nevojshëm. Ato duhen të shoqërohen me biografi dhe dokumente, dëshmi dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së personalitetit të propozuar.

6.7. Iniciativa dhe propozimet nga pika 6.6, i dorëzohen për procedim të mëtejshëm të komisionit të zgjedhur nga Kuvendi Komunal, i cili vepron sipas procedurave të parapara me dispozita të kësaj Rregulloreje.

NENI 7 TITULLI "DËSHMORËT E JUNIKUT"

7.1. Titulli "Dëshmorët e Junikut", jepet nga Kryetari i Komunës me miratim nga Kuvendi Komunal i Junikut, me rastin e Ditës së Çlirimit të Junikut dhe datave të rëndësishme për Junikun dhe vendin.

7.2. Ky titull u jepet personaliteteve të shquara të Komunës së Junikut dhe me gjerë, për merita dhe kontribute të jashtëzakonshme dhe të shquara në të mirë të kombit, që kanë një veprimtari të rëndësishme dhe të gjerë në rrafshin kombëtar, që kanë formuar një personalitet të pastër dhe kanë shfaqur cilësi të larta njerëzore në fushën e humanizmit dhe sakrificës sublime.

7.3. Ky titull mund t'u jepet edhe pas vdekjes personaliteteve të cekura në nenin 7 paragrafi 7.2.

7.4. Propozimet për dhënien e këtij titulli duhet të bëhen nga institucione të rëndësishme shtetërore apo të qeverisjes vendëse si dhe nga shoqatat dhe grupet e qytetarëve, duke mundësuar një konsensus më të gjerë të nevojshëm dhe të plotësuar me biografi dhe dokumente, dëshmi dhe vlerësime zyrtare të veprimit të personalitetit të propozuar.

7.5. Ky titull shoqërohet me Pllaketën "Dëshmorët e Junikut" dhe formularin përcjellës të formatit A4.

7.6. Pllaketa e punuar me rreth ari prej 25 gramëve, e dimensionit prej 10 cm, vendoset në mes të kutisë së formatit A4 dhe simbolizon emblemën e projektit të "Pllakës Përkujtimore të rënëve të Junikut për lirinë e Kosovës" me rreze në drejtim të jashtëm.

7.7. Formulari është 150 gramësh, ngjyrë ari, e formatit A4 dhe ka në fillim emblemën e institucioneve shtetërore, numrin dhe datën e Vendimit, nënshkrimin e Kryesuesit të Kuvendit Komunal, në njërën anë në fund të letrës dhe të Kryetarit të Komunës, në fund të anës tjetër. Në mes jepet vula e Komunës. Në mes të letrës, me shkronja të mëdha të shtypit, shënohet emri dhe mbiemri i marrësit të çmimit, me titull "Pllaketa e Artë Dëshmorët e Junikut" dhe fusha e kontributit të dhënë.

7.8. Materialet si: Vendimet, dhënia e çmimit dhe negativi i ndarjes së çmimit ruhen nga ana e Shërbimit Profesional të Kuvendit dhe evidentohen në fletoren e veçantë që përdoret për këto qëllime.

NENI 8

TITULLI "MARTIRËT E JUNIKUT"

7.1. Titulli "Martirët e Junikut", jepet nga Kryetari i Komunës me miratim nga Kuvendi Komunal i Junikut, me rastin e Ditës së Çlirimit të Junikut dhe datave të rëndësishme për Junikun dhe vendin.

7.2. Ky titull u jepet personaliteteve të Komunës së Junikut dhe me gjerë, për merita dhe kontribute të jashtëzakonshme dhe të shquara në të mirë të kombit, që kanë një veprimtari të rëndësishme dhe të gjerë në rrafshin kombëtar, që kanë formuar një personalitet të pastër dhe kanë shfaqur cilësi të larta njerëzore në fushën e humanizmit dhe sakrificës sublime.

7.3. Ky titull mund t'u jepet edhe pas vdekjes personaliteteve të cekura në nenin 7 paragrafi 7.2.

7.4. Propozimet për dhënien e këtij titulli duhet të bëhen nga institucione të rëndësishme shtetërore apo të qeverisjes vendëse si dhe nga shoqatat dhe grupet e qytetarëve, duke

mundësuar një konsensus më të gjerë të nevojshëm dhe të plotësuar me biografi dhe dokumente, dëshmi dhe vlerësime zyrtare të veprimtarisë së personalitetit të propozuar.

7.5. Ky titull shoqërohet me Pllaketën "Martiret e Junikut" dhe formularin përcjellës të formatit A4.

7.6. Pllaketa e punuar me rreth ari prej 25 gramëve, e dimensionit prej 10 cm, vendoset në mes të kutisë së formatit A4 dhe simbolizon emblemën e projektit të "Pllakës Përkujtimore të rënëve të Junikut për lirinë e Kosovës" me rreze në drejtim të jashtëm.

7.7. Formulari është 150 gramësh, ngjyrë ari, e formatit A4 dhe ka në fillim emblemën e institucioneve shtetërore, numrin dhe datën e Vendimit, nënshkrimin e Kryesuesit të Kuvendit Komunal, në njërën anë në fund të letrës dhe të Kryetarit të Komunës, në fund të anës tjetër. Në mes jepet vula e Komunës. Në mes të letrës, me shkronja të mëdha të shtypit, shënohet emri dhe mbiemri i marrësit të çmimit, me titull "Martirët e Junikut" dhe fusha e kontributit të dhënë.

7.8. Materialet si: Vendimet, dhënia e çmimit dhe negativi i ndarjes së çmimit ruhen nga ana e Shërbimit Profesional të Kuvendit dhe evidentohen në fletoren e veçantë që përdoret për këto qëllime.

NENI 9 ÇMIMI "DIN MEHMETI"

8.1. Çmimi "Din Mehmeti", u jepet artistëve më të shquar dhe personaliteteve më të rëndësishme të arsimit, artit, shkencës dhe kulturës për aktivitete të evidentuara në nivel kombëtar e ndërkombëtar, të vlerësuar me tituj, urdhra e medalje për veprimtarinë e tyre krijuese e interpretuese, që kanë një personalitet të pastër qytetarie dhe që gëzojnë popullaritet në komunitet.

8.2. Ky çmim u jepet edhe pas vdekjes atyre personaliteteve të qytetit që vazhdojnë të mbeten në memorie si personalitete të veprimtarisë artistike, krijuese e shkencore, si shembuj të rrallë të vlerave dhe kontributeve të rëndësishme.

8.3. Çmimi përbëhet nga mbishkrimi "Din Mehmeti", në sipërfaqe të së cilës vihet emblema e Komunës së Junikut, në pjesën e epërme shkruhet emri i marrësit të çmimit dhe emblema e Komunës, në paketimin e së njëjtës me shkronja ngjyrë ari shkruhet: "Din Mehmeti".

8.4. Çmimi "Din Mehmeti" shoqërohet me një fletë përcejlje, në të cilën shënohen të dhënat për dhënësin e çmimit si dhe të dhënat personale të fituesit të çmimit si dhe motivacioni për dhënien e çmimit të atij fituesi.

8.5. Gjatë një viti kalendarik çmimi mund ti jepet vetëm një fituesi.

8.6. Propozimet iniciuese për dhënien e këtij çmimi mund të bëhen nga organet komunale, ato arsimore, kulturore, sportive, grupet e qytetarëve dhe shoqëria civile.

8.7. Propozimet nga pika 8.6 i dorëzohen për procedim të mëtejshëm komisionit të zgjedhur të Kuvendit Komunal, i cili vepron sipas procedurave të parapara me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

NENI 10

MEDALJA "SPORTISTI I VITIT"

9.1. Medalja "Sportisti i Vitit", u jepet personaliteteve më të shquara për kontribute të veçanta dhe tepër të rëndësishme, që kanë krijuar një personalitet të lartë, kanë ndikuar në zhvillimin e sporteve dhe përgatitjen e brezave të tërë sportistësh, kanë arritur rezultate të larta e të qëndrueshme dhe që kanë treguar cilësi të veçanta njerëzore.

9.2. Titulli përbëhet nga një medalje me diametër 6 cm, ku në pjesën e lartë nën rreth shkruhet: "Kuvendi i Komunës së Junikut", më poshtë shkruhet me ngjyrë ari: "Sportisti i Vitit" dhe në pjesën e fundit shkruhet viti i fitimit të medaljes.

9.3. Medalja shoqërohet me një fletë përcjellje, në të shkruhen shënimet për dhënësin e titullit dhe shënimet personale të fituesit të titullit si dhe motivacioni për dhënien e titullit atij fituesi.

9.4. Në një vit kalendarik medalja "Sportist i Vitit" mund ti jepet vetëm një fituesi.

9.5. Iniciativat dhe propozimet për dhënien e kësaj medaljeje duhet të bëhen nga institucionet e sportit, klubet sportive, shoqatat sportive, grupe sportistësh apo qytetarësh që përfaqësojnë nivelet më të gjëra të komunitetit dhe që shoqërohen me biografi përkatëse, dokumente, dëshmi dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së personalitetit të propozuar.

9.6. Iniciativa dhe propozimet nga pika 9.5 i dorëzohen për procedim të mëtejshëm komisionit të zgjedhur në Kuvendin Komunal, sipas procedurave të parapara me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

NENI 11

Ndarja e çmimeve me rastin e Ditës së Çlirimit të Junikut "13 QERSHORI"

10.1. Me rastin e Ditës së Çlirimit të Junikut ndahen tituj, çmime, dekorata, mirënjohje dhe falënderime.

10.2. Me rastin e kësaj dite organizohen aktivitete të larmishme kulturore – artistike si dhe mbahet koncerti muzikor në Qendër të Qytetit.

10.3. Me mbikëqyrjen e organizimit dhe të gjitha aktiviteteve tjera të manifestimit të Ditës së Çlirimit, merret Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, ndërkah drejtë për së drejti me organizimet e tilla merret Këshilli Organizativ për kremtimin e Ditës së Çlirimit, i formuar nga Kryetari i Komunës.

NENI 12

MIRËNJOHJET DHE FALËNDERIMET

11.1. "Mirënjohjet" dhe "Falënderimet", u jepen në shenjë respekti, atyre personaliteteve, të cilat kanë dhënë një kontribut të veçantë, të dallueshëm dhe të rëndësishëm në fusha të ndryshme në të mirë të komunitetit.

11.2. Fletë Mirënjohja përbëhet nga një fletë e kualitetit të lartë, me dimension A4, prej 150 gramësh. Në tërë sfondin e fletës është emblema e Komunës, kurse në pjesën e sipërme të saj shkruhet: Kuvendi i Komunës së Junikut, numri dhe data e dhënies së titullit. Në mesin e fletës shkruhet: "Mirënjohje" ose Falënderim", me emrin dhe mbiemrin e fituesit, nën të motivacioni i dhënies së saj, kurse në fund të saj shkruhet organi apo emri dhe mbiemri i dhënësit të saj dhe vula e Komunës.

11.3. Iniciativat dhe propozimet mund të vijnë nga organet komunale, institucionet e tjera arsimore, kulturore, sportive, shoqëria civile dhe qytetarët. Me rastin e Ditës së Pavarësisë, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport organizon aktivitet në kuadër të Krosit "Vrapimi i Pavarësisë", që mbahet çdo vit me 17 Shkurt, në Junik dhe jep Mirënjohje për këtë aktivitet.

11.4. Mirënjohjet dhe Falënderimet i jep Kryetari i Komunës, Drejtorët e Drejtorive dhe Drejtorët e Institucione tjera vartëse të Komunës.

11.5. Të gjitha Institucionet, të cilat ndajnë Mirënjohje dhe Falënderime, janë të obliguara të mbajnë evidencë, protokoll apo regjistër të veçantë me të gjitha shënimet për lëshimin e tyre dhe dhënien e tyre, po ashtu mbajnë edhe Librin e Kujtesës, ku personalitetet e dalluara shënojnë përshtypjet e tyre.

NENI 13

Procedura, mënyra dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve dhe shpërblimeve tjera

FORMIMI I KOMISIONIT VLERËSUES

12.1. Kuvendi i Komunës, sipas propozimit të Kryetarit të Komunës për ndarjen e titujve, çmimeve, dhënien e dekoratave, medaljeve dhe shpërblimeve të tjera të parapara me këtë Rregullore, formon komision të veçantë vlerësues ad hoc për secilin titull - shpërblim.

12.2. Kuvendi i Komunës do të marrë vendim të veçantë për përbërjen e komisioneve në përputhje me dispozitat ligjore të Statutit të Komunës, të rregulloreve të tjera në fuqi dhe të kësaj Rregulloreje.

12.3. Përbërja e komisionit nga paragrafi 12.1 i këtij neni, ka 5 anëtarë, prej të cilëve, 2 anëtarë i cakton Kryetari i Komunës nga Ekzekutivi, 2 anëtarë caktohen nga legjislativi i Komunës dhe 1 anëtarë caktohet nga Shoqëria Civile.

12.4. Anëtar i komisionit nuk mund të jetë personi, i cili është propozuar e as personat e tjerë të

cilët kanë çfarë do afërsie ose interesi me kandidatin e propozuar. Në rastet kur komisioni nuk ka pasur njohuri, Kryetari i Komunës e anulon propozimin për kandidatin e tillë.

12.5. Komisionet për punën e tyre mund të nxjerrin akte të tjera të veçanta, të cilat në mënyrë më të detajuar përcaktojnë procedurën e punës. Ato duhet të jenë në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

12.6. Mbledhjet e Komisioneve janë publike dhe për takimet e tyre punuese dhe rezultatet mbahet procesverbal i veçantë.

NENI 14 PROPOZIMET E KOMISIONIT

13.1. Komisioni propozim vendimin për nominim e merr me shumicë votash.

13.2. Në raste të veçanta, Komisioni mund të kërkojë ekspertizë për vlerësimin e propozimit për shpërblim.

13.3. Nëse në Komision vijnë dy apo më shumë propozime të një vlere apo rëndësie, atëherë Komisioni vlerësues përcakton kriteret për përzgjedhjen e njërit me votim të fshehte, me short ose duke e ndarë në dy pjesë shpërblimin.

13.4. Komisioni për vlerësim mund të mos përzgjedhë kandidatet e propozuar, nëse:

13.4.1. Nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e kësaj rregulloreje,

13.4.2. Mungojnë të dhëna dhe argumente për propozimet, dhe

13.4.3. Vlerëson se asnjë propozim nuk është i merituar.

NENI 15 SHQYRTIMI DHE APROVIMI I PROPOZIMEVE

14.1. Kuvendi i Komunës shqyrton propozimet e komisioneve për ndarjen e titujve apo çmimeve të tjera dhe merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, Statutit të Komunës dhe akteve të tjera në fuqi.

14.2. Votimi do të jetë publik, por Kuvendi Komunal mund të vendos që votimi të jetë me vota të fshehta.

14.3. Nëse Kuvendi vendos që votimi të bëhet me vota të fshehta, atëherë Kuvendi do të formojë Komisionet kompetente për përcjelljen e votimit, sipas dispozitave ligjore, Statutit të Komunës, Rregullores për Punën e Kuvendit dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje.

NENI 16

DORËZIMI I TITULLIT

15.1. Pas marrjes së vendimit për ndarjen e titullit të caktuar apo të ndonjë çmimi tjetër, Kuvendi i Komunës do të organizoj Seancën Solemnë dhe ceremoninë e dorëzimit. Vendimin e lexon Kryesuesi i Kuvendit i cili e fton Kryetarin e Komunës që ta dorëzojë titullin apo shpërblimin tjetër që ndahet.

15.2. Pas marrjes së vendimit për ndarjen e titullit të caktuar apo të ndonjë çmimi tjetër në rastet kur ceremonia nuk organizohet në objektin e Kuvendit Komunal, caktohet organi ose personi kompetent për dorëzimin e tij në emër të Kuvendit Komunal (Komunës), i cili edhe do të organizoj ceremoninë e dorëzimit, nëse me këtë Rregullore nuk është paraparë ndryshe.

15.3. Titujt, medaljet dhe shpërblimet e tjera, zakonisht mund të jepen gjatë organizimit të ceremonive, me rastin e ditëve të festave apo në ditët përkujtimore, por edhe gjatë takimeve, kontakteve me subjektet komunale dhe vizitave që i bëjnë personalitetet e shquara të Junikut.

15.4. Organizimin e ceremonisë së dhënies së titujve dhe shpërblimeve të tjera, Kuvendi Komunal e bënë në bashkëpunim me organet kompetente të Administratës Komunale, në përputhje me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit dhe të akteve të tjera në fuqi.

15.5. Mirënjohjet dhe falënderimet zakonisht u ndahen personaliteteve të shquara me rastin e mbajtjes së turnirëve sportive, shfaqjeve, tubimeve dhe datave të tjera me rendësi.

15.6. Me rastin e ndarjes së titullit, medaljeve dhe çmimeve të tjera, Kuvendi Komunal mund të vendosë me vendim të veçantë që ata tituj dhe shpërblime tjera të përcillen edhe me shuma të caktuara financiare.

NENI 17

Bartja dhe Revokimi i Titujve

16.1. Bartësi i titullit është i obliguar që titullin ta bartë me dinjitet, duke pasur parasysh çdo herë sjelljet e tij në jetë dhe angazhimin e përditshëm dhe të ruajë autoritetin e Kuvendit të Komunës.

16.2. Bartësit të titullit mund t'i revokohet titulli, nëse ai me sjelljet e veta në shkallë të lartë e njollos institucionin e Kuvendit të Komunës, ose në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës, dënohet me dënim burgu prej së paku gjashtë muaj.

16.3. Revokimi bëhet në procedurën e paraparë paraprake si për dhënien e titullit (shpërblimit), ndërsa vendimi përfundimtar merret në mbledhje të rregullt të Kuvendit të Komunës.

NENI 18

II.DISPOZITAT E FUNDIT DHE PËRFUNDIMTARE

17.1. Në rast të kolizionit të dispozitave të kësaj Rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale si dhe akteve të tjera të Pushtetit Qendror dhe Ministror të linjës, si dhe në raste të zbrastirës tjetër juridike, në këtë rregullore, drejtpërsëdrejti vlejnë dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 i dt. 20 shkurt 2008, apo edhe dispozitat e tjera të Pushtetit qendror dhe

ministrisë kompetente të linjës që rregullon çështjen lëndore deri në harmonizimin ligjor të këtij akti.

NENI 19

Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje

19.1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje obligohet Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.

NENI 20

20.1. Kjo Rregullore do të nënshtrohet diskutimit publik sipas dispozitave të Ligjit, Statutit të Komunës, Rregullores për Transparencë të Komunës dhe të akteve të tjera pozitive.

NENI 21

Hyrja në Fuqi


21.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi Komunal dhe do të publikohet në Ueb Faqen e Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Prot. 2-155/3350
Nje. Org. 2
Nr. i taq. 17
Data 19/05/2021



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	14.05.2021
PËR/ZA/TO:	Muharrem Krasniqi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Agron Kuçi - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Kosovare Gacaferi- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF dhe Kuvendit komunal Raportin tre mujor financiar Janar Mars për vitin 2021



Në bazë të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr: 03L/048 neni 45, paragrafi 45.4 ku është detyrë e Egzekutivit që në periudha tremujore dhe vjetore të raportojë para Kuvendit Komunal, atëherë kërkojmë që të shtohet në rend dite në mbledhjen e ardhshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, Raporti tremujor Janar Mars mbi Buxhetin dhe Shpenzimet për vitin 2021.

Të bashkangjitur në kërkesë keni raportin e përgatitur nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO



KOMUNA E JUNIKUT
OPSTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK

KOMUNA E JUNIKUT

**RAPORTI I BUXHETIT
KOMUNAL PËR
PERIUDHËN JANAR -
MARS/ 2021**

Junik, Prill -2021

Informata -I- Financiare Periodike 2021

Kërkesat për raportim

Informata Financiare Komunale për periudhën Janar – Mars 2021, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunale Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesve do të prezantohet për 14 programet buxhetore :

1. Zyra e Kryetarit
2. Kuvendi Komunal
3. Administrata e Përgjithshme
4. Buxhet dhe Financa
5. Zhvillim Ekonomik
6. Shërbimet publike dhe Inspeksion
7. Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis
8. ZKK (Zyra Komunale për Komunitete)
9. Shëndetësi
10. Mirëqenie Sociale
11. Shërbimet e kujdesit primar
12. Arsimit, Kulturë, Rinia dhe Sport
13. Arsimi i mesëm
14. Arsimi fillor

TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Junikut. Komuna e Junikut kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e saja financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Komuna e Junikut nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Junikut janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të Parave të Gatshme.

Buxheti i aprovuar në Asamblenë Komunale për vitin 2021 është në vlerë **1,546,704.00€** i cili ka pësuar ndryshime gjatë periudhës Janar – Mars 2021 për të hyrat nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2020 në vlerë **2,469.85€**, nga niveli Qendror është rritur kategoria e pagave në shume prej **6,089.93€** për mbulimin e shtesave për përfituesit nga Ligji për rimëkëmbje ekonomike siç janë Arsimi, Shëndetësia, Zjarrfikësit dhe Sociali. Buxheti përfundimtar i përgjithshëm duke përfshirë edhe donacionet është në vlerë **1,555,263.78€**.

Raport i ekzekutimit të Buxhetit

		Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Pranimet - Alokimet	Pagesat (Shpenzimi)	Progresi me plan	% me alokim
Përshkrimi	Ligji Nr. 07-L-041	SIMFK	SIMFK			në, %	në, %
a	b	c	d	e	f=e/c	g=e/d	
Gjithsej Pagesat	1+2+3+4+5	1+2+3+4+5	1+2+3+4	1+2+3+4+5			
Totali	1,546,704.00	1,555,263.78	421,928.16	353,590.84	22.74%	83.60%	
Paga dhe Meditje	1,147,799.00	1,153,888.93	300,070.91	300,070.91	26.01%	100.00%	
Mallrat dhe Shërbimet	172,900.00	172,917.50	64,440.00	31,590.54	18.27%	49.02%	
Shpenzimet Komunale	36,200.00	36,200.00	11,365.00	6,429.39	17.76%	56.57%	
Subvencione dhe Transferet	30,500.00	30,500.00	14,294.90	500.00	1.64%	3.50%	
Investimet Kapitale	159,305.00	161,757.35	31,757.35	15,000.00	9.27%	47.23%	
Granti i Përgjithshëm	1	1,423,902.00	1,396,293.93	404,740.91	353,090.84	25.29%	87.24%
Paga dhe Meditje	1,147,799.00	1,153,888.93	300,070.91	300,070.91	26.01%	100.00%	
Mallrat dhe Shërbimet	166,900.00	166,900.00	64,000.00	31,590.54	18.93%	49.36%	
Shpenzimet Komunale	36,200.00	36,200.00	11,365.00	6,429.39	17.76%	56.57%	
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Investimet Kapitale	73,003.00	39,305.00	29,305.00	15,000.00	38.16%	51.19%	
Rezerva	2	-	80,000.00	-	-	0.00%	#DIV/0!
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Mallrat dhe Shërbimet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Investimet Kapitale	-	80,000.00	-	-	0.00%	#DIV/0!	
Të hyrat vetanake	3	122,802.00	76,500.00	14,717.40	590.00	0.65%	3.40%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Mallrat dhe Shërbimet	6,000.00	6,000.00	422.50	-	0.00%	0.00%	
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Subvencione dhe Transferet	30,500.00	30,500.00	14,294.90	500.00	1.64%	3.50%	
Investimet Kapitale	86,302.00	40,000.00	-	-	0.00%	#DIV/0!	
Mjetet e bartura	4	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Mallrat dhe Shërbimet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Investimet Kapitale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Grantet - Donacionet	5	-	2,469.85	2,469.85	-	0.00%	0.00%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Mallrat dhe Shërbimet	-	17.50	17.50	-	0.00%	0.00%	
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	
Investimet Kapitale	-	2,452.35	2,452.35	-	0.00%	0.00%	

Gjatë këtij tre mujori të vitit 2021 ka ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe aktual siç janë: Transferi i donacioneve në shumë totale **2,469.85 €**, prej tyre **260.98 €** nga **UN-HABITAT** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **17.50 €** nga **KOSTT** në kategorinë Mallra dhe shërbime, **356.50€** nga **SAVE THE CHILDREN** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **1,834.87€** nga **DEMOS** dhe **SIDA** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale .

Nga kategoria e investimeve kapitale është ndarë shuma prej **80,00.00** e cila është e vendosur si Rezerva pasi që një projekt kapital nuk është aprovuar nga niveli qendror, dhe ne te ardhmen me vendim të kuvendit komunal do të vendoset se ne cilat projekte do të destinohen këto mjete.

Kategoria e pagave është rritur në shume prej **6,089.93€** për mbulimin e shtesave në paga për përfutjesit nga Ligji për rimëkëmbje ekonomike siç janë Arsimi, Shëndetësia, Zjarrfikësit dhe Sociali

KOMUNA E JUNIKUT

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA


Telefon : +381 390 370 112, Centrex, 0038 200/44 501

TË HYRAT BUXHETORE 2021

Pasqyra aktuale Buxhetore 2021, si dhe pasqyrat finale buxhetore për vitet paraprake
Tabela - 2

Burimi i mjeteve	Pranimet 2018	Pranimet 2019	Pranimet 2020	Pranimet 2021	Progresi 21/20	Progresi 21/19
1	2	3	4	5	7=5/4	8=5/3
Grandi Qeveritar	1,982,603.91	1,671,207.99	1,490,747.00	1,429,991.93	95.92%	85.57%
Të hyrat vetanake	99,009.00	113,557.00	137,199.00	122,802.00	89.51%	108.14%
Mjetet e Bartura	38,528.78	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Donacionet	31,906.48	47,241.85	2,469.85	2,469.85	100.00%	5.23%
Gjithsej	2,152,048.17	1,832,006.84	1,630,415.85	1,555,263.78	95.39%	84.89%

GRAFIKONI I BURIMEVE FINANCIARE KOMUNALE (% E PJESMARRJES)




TË HYRAT PERIODIKE NGA GRANTI I QEVERISË

Klasifikimi ekonomik	2021	2020	2019	2018
	BKK	BKK	BKK	BKK
	€ '	€ '	€ '	€ '
Pagat dhe rrogat	1,153,888.93	1,161,458.00	1,127,722.99	1,118,322.46
Mallrat dhe shërbimet	166,900.00	172,899.00	172,899.00	149,956.00
Shërbimet komunale	36,200.00	36,200.00	36,200.00	30,000.00
Subvencionet dhe transferet	-	-	-	-
Shpenzimet kapitale	73,003.00	120,190.00	334,386.00	333,175.00
	1,429,991.93	1,490,747.00	1,671,207.99	1,631,453.46

TË HYRAT VETANAKE PERIODIKE 2021


Përveç Grandeve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka grumbulluar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: Tatimi në pronë, Te hyrat nga Shëndetësia, Te hyrat nga Regjistrimi i Automjeteve etj... Të hyrat totale vetanake të grumbulluara Janar - Mars 2021 kanë arritur në shumën prej **34,741.60 €** që përbën **28.29%** të planifikimit vjetor (**122,802,00€**).

GRAFIKONI I TË HYRAVE VETANAKE PËRIODIKE 2018 - 2021



Të hyrat vetanake kryesore periodike Janar – Mars 2021

Te Hyrat nga:	Realizimi 2018	Realizimi 2019	Realizimi 2020	Planifikimi 2021	Realizimi 2021	Progresi me plan.	Progresi me /2020	Progresi me /2019	% në total
	1	2	3	4	5	6 = 5 / 4	7 = 5 / 3	8 = 5 / 2	9 = 5 / total
Tatimi në pronë	11,453.69	14,302.79	22,608.33	69,553.00	25,329.10	36%	112%	177%	72.9%
Te hyrat nga Shendetsia	1,182.40	1,155.90	1,229.00	6,000.00	794.50	13%	65%	69%	2.3%
Te hyrat nga Administrata	1,734.00	1,656.00	1,477.00	6,900.00	1,329.00	19%	90%	80%	3.8%
Regjistrimi i Automjeteve	1,160.00	1,111.00	1,134.00	5,900.00	1,180.00	20%	104%	106%	3.4%
Te hyrat nga Gjobat ne trafik	800.00	1,500.00	1,165.00	-	915.00	#DIV/0!	79%	61%	2.6%
Te hyrat nga lejet per ushtrim te veprimtarise	920.00	5,903.36	710.00	6,000.00	176.00	3%	25%	3%	0.5%
Te hyrat nga Urbanizmi	7,600.50	982.00	1,722.00	22,449.00	2,788.00	12%	162%	284%	8.0%
Të hyrat tjera	528.00	680.00	1,105.00	6,000.00	2,230.00	37%	202%	328%	6.4%
Totali	25,378.59	27,291.05	31,150.33	122,802.00	34,741.60	28%	112%	127%	100%



Ne kategorinë Të hyrat tjera bëjnë pjesë: (Të hyrat nga Qiraja 1100.00€, Të hyrat nga shërbimet publike-inspeksioni 1,130.00 €) gjithsejtë **2,230.00€**

Periudha Janar - Mars 2021 karakterizohet me një realizim të të hyrave në total 34,741.60 € apo 28.29% në raport me planifikimin vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2020 kemi realizuar 111.53% apo 11.53% më shumë, shprehur në vlerë monetare diferenca është 3,591.27 € më shumë.


SHPENZIMET BUXHETORE 2021

Planifikimi Buxhetor për 2021 duke përfshirë edhe donacionet është 1,555,263.78€, gjatë kësaj periudhe buxhetore janë alokuar mjete në vlerë 421,928.16€ ndërsa shpenzuar 353,590.84 €, apo 69.46% e buxhetit të alokuar.

Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike.

Nr	Përshkrimi	2018	2019	2020	2021	Alokimet/21	Progresi %	
1	2	3	4	5	6	7	8=6/5	9=6/7
1	Pagat	264,881.50	274,037.24	277,590.16	300,070.91	300,070.91	108.10%	100.00%
2	Mallra e shërbime	27,252.72	22,551.86	29,034.22	31,590.54	64,440.00	108.80%	49.02%
3	Shpenzi. komunale	8,339.15	6,841.47	6,725.75	6,429.39	11,365.00	95.59%	56.57%
4	Subvencione	4,500.00	-	-	500.00	14,294.90	#DIV/0!	3.50%
5	Shpenzi. Kapitale	81,051.32	-	-	15,000.00	31,757.35	#DIV/0!	47.23%
Totali		326,024.69	303,430.57	313,350.13	353,590.84	421,928.16	112.84%	83.80%

GRAFIKONI I SHPENZIMEVE DHE % E PJESMARRJES NË SHPENZIMET



- Pagat dhe mëditjet të alokuara në vlerë 300,070.91€ janë shpenzuar 300,070.91€ apo 100.00% e mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak shpenzimi në këtë kategori është më i lartë për 8.10% për shkak të ndikimit të ndryshimeve bazuar ne ligjin per

rimëkëmbje ekonomike dhe te përvojës së punës. Pjesëmarrja e pagave në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 84.86%.

- Mallrat & shërbimet të alokuara në vlerë 64,440.00€ janë shpenzuar 31,590.54€ në përqindje 49.02% e mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 8.80%. Pjesëmarrja e Mallrave & Shërbimeve në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 8.93%.
- Shpenzimet komunale - Komunalit të alokuara në vlerë 11,365.00€ janë shpenzuar 6,429.39€ ose në shkallën prej 56.57% të mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të ulëta për 4.41%. Pjesëmarrja e shpenzimeve komunale në shpenzimin total komunal është 1.82%.
- Subvencionet të alokuara në vlerë 14,294.90€ janë shpenzuar 500.00€ ose në shkallën prej 3.50% të mjeteve të alokuara. Në vitin paraprak nuk kemi pasur shpenzime në këtë kategori në këtë periudhë. Pjesëmarrja e shpenzimeve të subvencioneve në shpenzimin total komunal është 0.14%.
- Shpenzimet kapitale të alokuara në vlerë prej 31,757.35€ janë shpenzuar 15,000.00€ ose në shkallën prej 47.23% të mjeteve të alokuara. Në vitin paraprak nuk kemi pasur shpenzime në këtë kategori në këtë periudhë. Pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimin total komunal është 4.24%.
- Në total mjetet e alokuara për periudhën tremujore të vitit 2021 në vlerë prej 421,928.16€ janë shpenzuar në vlerë prej 353,590.84€ ose në shkallën 83.80% të mjeteve të alokuara, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 shpenzimet janë më të larta për 12.84%.

RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA , MALLA & SHERBIME SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Z.Kryetarit	Administrata	Zh. Ekono.	Sh. Publike	K. Komunal	B.Financa	Urbanizem
Paga neto	15,124.50	18,260.50	11,327.55	13,785.40	12,150.34	12,280.77	8,936.55
Sindikata -0.1% te 0.50%	-	33.72	22.65	29.95	-	7.41	21.57
Antarsimi Oda e Infermiereve	-	-	-	-	-	-	-
Antarsimi Oda e Mjekve	-	-	-	-	-	-	-
Tatimi në paga	1,162.86	829.58	573.18	869.93	439.96	573.39	552.75
Kontributi pensional i punëtorëve	857.28	1,006.56	627.57	772.96	613.96	676.98	500.55
Kontributi pensional i Punëdhënësit	857.28	1,006.56	627.57	772.96	613.96	676.98	500.55
Vendim gjykatë	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI I PAGAVE & MED.	18,001.92	21,136.92	13,178.52	16,231.20	13,818.22	14,215.53	10,511.97
Shpenzimet e udhimit në Vendë	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e udhët. Jashtë Vendi	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e internetit	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet tjera te telefonit	169.96	79.59	104.61	312.54	33.28	120.77	87.97
Shpenz. e Tjera te kom. (postare)	-	18.00	-	-	-	-	-
Sherbimet e perfaqesimit avokatur	-	-	-	-	-	-	-
Shërbime shtypje jo marketing	-	-	-	-	-	-	-
Shërbime kontraktuese tjera	468.37	1,566.86	-	3,401.64	-	914.63	7.23
Shërbime teknike	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet per anëtarësim	-	-	912.60	-	-	-	-
Mobile me pak se 1000€	-	-	-	-	-	-	-
Kompjuterë me pak se 1000€	-	-	-	-	-	-	-
Makina fotokopjuese	-	-	-	-	-	-	-
Pajisje tjera	-	-	-	-	-	-	-
Pajisje trafiku < 1000	-	-	-	-	-	-	-
Mobile (1000 - 5000)	-	-	-	-	-	-	-
Telefona	-	-	-	-	-	-	-
Furnizim i Zyrës	-	-	-	458.00	-	462.00	-
Furnizim me ushqim dhe pije	32.60	43.30	-	-	-	-	-
Furnizim me medikamente	-	-	-	-	-	-	-
Furnizim higjienike	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e veshmbathjes	-	-	-	-	-	-	-
Akomodimi	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e varrimit	-	-	-	-	-	-	-
Vaj	-	-	-	-	-	-	-
Nafta për ngrohje	-	2,622.30	-	137.26	-	-	-
Dru	-	-	-	-	-	-	-
Karburant për Gjenerator	-	437.05	-	-	-	-	-
Karburant për automjete	-	1,058.79	123.30	527.46	-	141.81	-
Avans për para te imet (patty cash)	-	-	-	-	-	-	-
Previzion Bankar	-	-	-	-	-	-	-
Regjistrimi dhe sig. automjeteve	-	-	324.65	1,556.90	-	-	384.72
Taksa komunale e rexe automjetit	-	-	-	-	-	-	-
Sigur. I ndërtesave dhe të tjerave	-	-	-	-	-	-	-
Mirëm dhe riparim i automjeteve	-	1,419.40	-	1,503.32	-	-	626.58
Mirëmbajtja e ndërtesave	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja e rrugëve	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmb. e teknologjisë informatike	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve	-	-	-	-	-	-	-
Qiraja	-	-	-	-	-	-	660.00
Reklammat dhe konkurset	900.00	600.00	-	-	-	-	-
Botime dhe publikime	-	-	-	-	-	-	-
Dreka zyrtare	-	-	-	-	-	-	-
Vendim gjykatë	-	-	-	-	-	-	-
Pag. neni 39.2 LMFPF	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI M & SH	1,570.93	7,845.29	1,465.16	7,897.12	33.28	1,639.21	1,766.50

RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA, MALLA & SHERBIME SIPAS DREJTORIVE

Përkthimi	Ad. Arsini	Ars. fillor	A. 1 mesem	Ad. Shendet.	QKMF	Sh. Sociale	ZLK	Totali periodik 2021
Paga neto	7,490.16	60,347.07	25,350.63	3,269.31	50,657.88	2,586.18	-	241,566.84
Sindikata -0.1% te 0.50%	13.83	286.26	118.26	-	306.51	11.15	-	851.31
Antarsimi Oda e Infermiereve	-	-	-	-	99.87	-	-	99.87
Antarsimi Oda e Mjekve	-	-	-	-	320.00	-	-	320.00
Tatimi në paga	467.61	3,440.86	1,482.65	215.25	3,601.69	145.59	-	14,355.30
Kontributi pensional i punëtorëve	419.58	3,372.45	1,418.57	183.39	2,854.55	144.35	-	13,448.75
Kontributi pensional i Punëdhënësit	419.58	3,372.45	1,418.57	183.39	2,854.55	144.35	-	13,448.75
Vendim gjykatë	-	11,980.09	4,000.00	-	-	-	-	15,980.09
TOTALI I PAGAVE & MED.	8,810.76	82,799.18	33,788.68	3,851.34	60,695.05	3,031.62	-	300,070.91
Shpenzimet e udhimit në Vendë	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e udhet. Jashtë Vendi	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e internetit	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet tjera te telefonit	-	70.21	129.98	64.89	-	-	-	1,173.80
Shpenz. e Tjera te kom. (postare)	-	-	-	-	-	-	-	18.00
Sherbimet e perfaqesimit avokatur	-	-	-	-	-	-	-	-
Sherbime shtypje jo marketing	-	-	-	-	-	-	-	-
Sherbime kontraktuese tjera	10.44	3,856.67	3,510.00	-	-	-	-	13,735.84
Sherbime teknike	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet per anëtarësim	-	-	-	-	-	-	-	912.60
Mobile me pak se 1000€	-	-	-	-	-	-	-	-
Kompiuterë me pak se 1000€	-	-	-	-	-	-	-	-
Makina fotokopjuese	-	-	-	-	-	-	-	-
Pajisje tjera	-	-	-	-	-	-	-	-
Pajisje trafiku < 1000	-	-	-	-	-	-	-	-
Mobile (1000 - 5000)	-	-	-	-	-	-	-	-
Telefona	-	-	-	-	-	-	-	-
Furnizim i Zyrës	-	-	-	-	-	-	-	920.60
Furnizim me ushqim dhe pije	-	60.35	-	-	-	-	-	136.25
Furnizim me medikamente	-	-	-	-	-	-	-	-
Furnizim higjienike	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e veshmbathjes	-	-	-	-	-	-	-	-
Akomodimi	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e varrimit	-	-	-	-	-	-	-	-
Vaj	-	-	-	-	-	-	-	-
Nafta për ngrohje	-	-	-	-	-	-	-	2,759.56
Dru	-	-	-	-	-	-	-	-
Karburant për Gjenerator	-	-	-	-	-	-	-	437.05
Karburant për automjete	-	35.44	-	53.26	118.19	-	-	2,058.25
Avans për para te imet (patty cash)	-	500.00	-	500.00	-	-	-	1,000.00
Previzion Bankar	-	-	-	-	-	-	-	-
Regjistrimi dhe sig. automjeteve	-	-	-	-	-	-	-	2,266.27
Taksa komunale e rexe automjetit	-	-	-	-	-	-	-	-
Sigur. I ndërtesave dhe të tjerave	-	-	-	-	-	-	-	-
Mirëm. dhe riparim i automjeteve	-	-	-	-	-	423.62	-	3,972.92
Mirëmbajtja e ndërtesave	-	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja e rrugëve	-	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmb. e teknologjisë informatike	-	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve	-	-	-	-	-	-	-	-
Qiraja	-	-	-	-	-	-	-	660.00
Reklamta dhe konkurset	-	-	40.00	-	-	-	-	1,540.00
Botime dhe publikime	-	-	-	-	-	-	-	-
Dreka zyrtare	-	-	-	-	-	-	-	-
Vendim gjykatë	-	-	-	-	-	-	-	-
Pag. neni 39.2 LMFPF	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI M & SH	10.44	4,522.67	3,679.98	618.15	318.19	423.62	-	31,590.54

SHPENZIMET ANALITIKE KOMUNALIVE, SUBVENCIONEVE DHE INVESTIMEVE KAPITALE

Përshkrimi	Z. Kryetorit	Administrata	Zh. Ekono.	Sh. Publike	K. Komunal	B. Financa	Urbanizim
Shpenzimet e energjisë elektrike		855.44	60.90	3,308.41	-	-	-
Shpenzimet e Ujët		20.48	10.80	119.95	-	-	-
Shpenzimet e Mbeturinave		-	-	216.00	-	-	-
Shpenzimet e Ngrohjes		-	-	-	-	-	-
Shpenzimet Telefonike		-	-	65.96	-	-	-
Pagesa Vendime gjyqore		-	-	-	-	-	-
TOTALI KOMUNALËVE		875.92	71.70	3,710.32	-	-	-
Subvencionet per etnitetet publike		-	-	-	-	-	-
Subvencionet per etnitetet jopublike	500.00	-	-	-	-	-	-
TOTALI SUBVENCIONEVE	500.00	-	-	-	-	-	-
Ndërtesa te banuara		-	-	-	-	-	-
Objekte Arsimore		-	-	-	-	-	-
Objektet kuturore		-	-	-	-	-	-
Objektet shendetesore		-	-	-	-	-	-
Auto Rrugëve		-	-	-	-	-	-
Rrugët Lokale		-	5,000.00	10,000.00	-	-	-
Trotualet		-	-	-	-	-	-
Kanalizimi		-	-	-	-	-	-
Ujësjetlësi		-	-	-	-	-	-
Furniz. Rrymë		-	-	-	-	-	-
Pajisje speciale mjeksore		-	-	-	-	-	-
Pajisje tjera		-	-	-	-	-	-
Mirmbajtja investive		-	-	-	-	-	-
automjete transporti (autoambulanca)		-	-	-	-	-	-
Transaksione Kapitale - enti. Publ.		-	-	-	-	-	-
Pag. neni 39.2 LMFP		-	-	-	-	-	-
Vendim gjykate		-	-	-	-	-	-
TOTALI I INVESTIMEVE		-	5,000.00	10,000.00	-	-	-
TOTALI I PËRGJITHSHËM	20,073.81	29,358.15	19,715.38	37,838.64	12,851.50	1,854.74	1,273.17

Përshkrimi	Ad. Archi	Ars. Tjlor	A. Tmesem	Ag. Shendet.	QKMF	Sh. Sociale	ZI/K	Totali periodik 2021
Shpenzimet e energjisë elektrike		251.79	47.59	-	846.16	84.28	-	5,454.57
Shpenzimet e Ujët		47.21	86.35	-	33.29	14.78	-	332.86
Shpenzimet e Mbeturinave		144.00	72.00	-	72.00	72.00	-	576.00
Shpenzimet e Ngrohjes		-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet Telefonike		-	-	-	-	-	-	65.96
Pagesa Vendime gjyqore		-	-	-	-	-	-	-
TOTALI KOMUNALËVE	-	443.00	205.94	-	951.45	171.06	-	6,429.39
Subvencionet per etnitetet publike		-	-	-	-	-	-	-
Subvencionet per etnitetet jopublike		-	-	-	-	-	-	500.00
TOTALI SUBVENCIONEVE	-	-	-	-	-	-	-	500.00
Ndërtesa te banuara		-	-	-	-	-	-	-
Objekte Arsimore		-	-	-	-	-	-	-
Objektet kuturore		-	-	-	-	-	-	-
Objektet shendetesore		-	-	-	-	-	-	-
Auto Rrugëve		-	-	-	-	-	-	-
Rrugët Lokale		-	-	-	-	-	-	15,000.00
Trotualet		-	-	-	-	-	-	-
Kanalizimi		-	-	-	-	-	-	-
Ujësjetlësi		-	-	-	-	-	-	-
Furniz. Rrymë		-	-	-	-	-	-	-
Pajisje speciale mjeksore		-	-	-	-	-	-	-
Pajisje tjera		-	-	-	-	-	-	-
Mirmbajtja investive		-	-	-	-	-	-	-
automjete transporti (autoambulanca)		-	-	-	-	-	-	-
Transaksione Kapitale - enti. Publ.		-	-	-	-	-	-	-
Pag. neni 39.2 LMFP		-	-	-	-	-	-	-
Vendim gjykate		-	-	-	-	-	-	-
TOTALI I INVESTIMEVE	-	-	-	-	-	-	-	15,000.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM	8,821.20	87,764.85	37,674.60	4,469.40	61,764.69	3,626.30	-	382,590.84

Shënime shpjeguese:

Në totalin e pagave të shpenzuara në vlerë prej **300,070.91€** janë nga granti i përgjithshëm, për pagesën e pagave të punëtorëve në listën e pagave.

Kategoria e Malirave dhe shërbimeve të shpenzuara në vlerë prej **31,590.54€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.

Kategoria e Komunalive të shpenzuara në vlerë prej **6,429.39€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.


Kategoria e Subvencioneve të shpenzuara në vlerë prej **500.00€** të gjitha janë nga të hyrat vetanake.

Kategoria e Investimeve Kapitale të shpenzuara në vlerë prej **15,060.00€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.

Shpenzimet sipas Drejtorive dhe progresi me periudhën e njëjtë të viteve paraprake

Shpenzimet Periodike sipas Drejtorive 2018-2021								
	Drejtoria	2018	2019	2020	2021	Alokimet 2021	Progr./ alokim	Progr. me 2020
1	Zyra e Kryetarit	27,191.44	23,760.71	23,652.20	20,072.85	34,236.82	58.6%	84.9%
2	Kuvendi Komunal	12,605.83	13,979.22	13,554.56	13,851.50	15,018.22	92.2%	102.2%
3	Administratë	27,026.93	26,413.40	29,609.24	29,858.13	37,586.92	79.4%	100.8%
4	Buxhet dhe Financa	15,415.83	15,275.59	15,085.79	15,854.74	16,840.53	94.1%	105.1%
5	Zhvillimi Ekonomik	42,070.97	14,447.73	14,262.77	19,715.38	37,609.37	52.4%	138.2%
6	Sh.publike	23,410.76	23,288.59	25,643.12	37,838.64	43,731.20	86.5%	147.6%
7	Planifikimi urban	63,876.55	10,488.82	11,505.53	12,278.47	13,529.47	90.8%	105.7%
8	ZKK	430.69	1,620.81	1,620.81	-	-	#DIV/0!	0.0%
9	Shëndetsia	59,975.97	63,453.53	65,854.95	69,860.48	80,820.51	86.4%	106.1%
12	Arsimi	114,019.72	110,702.17	112,561.16	134,260.65	142,555.12	94.2%	119.3%
Totali Buxhetor		386,024.69	303,430.57	313,350.13	353,590.84	421,928.16	83.8%	112.8%

GRAFIKONI I SHPENZIMEVE TE DREJTORIVE SI DHE PJESMARRJA NE SHPENZIMIN TOTAL



Në kuadër të Shëndetësisë janë të përfshira: Drejtoria e Shëndetësisë (Administrata), QKMF dhe Shërbimet Sociale.

Në kuadër të Arsimit janë të përfshira: Drejtoria e Arsimit (Administrata), Arsimi fillor dhe Arsimi i mesëm.

❖ Progresi i shpenzimeve kapitale sipas projekteve për vitin 2021

Emri i projektit	Kodi i projektit në Thesar	Buxheti 2021	Alokimet Mars/ 2021	Shpenzimet aktuale I - III / 2021	Struktura në %
	1	2	3	4	5
Participim i projekteve - (Un-Habitat)	88351	260.98	260.98	-	-
Rehabilitim i rrugëve lokale	46031	20,000.00	10,000.00	10,000.00	100.00
Bashkefinancim i projekteve	46030	9,305.00	9,305.00	-	-
Ndertimi i kanaleve të ujitjes	47283	10,000.00	5,000.00	-	-
Rregullimi i hapsirave sportive, rekreative dhe të amb	51003	10,000.00	-	-	#DIV/0!
Asfaltimi i rrugëve Lokale	45605	20,000.00	-	-	#DIV/0!
Hapja e rrugëve fushore	88352	10,000.00	5,000.00	5,000.00	100.00
Permires. i qasjes (Save the children)	94618	356.50	356.50	-	-
Ngritja e Performances (DEMOS)	92052	1,834.87	1,834.87	-	-
Totali		81,757.35	31,757.35	15,000.00	47.23

Mjetet e alokuara për Investime kapitale janë 31,757.35€ nga këto burime:

- Grandi 29,305.00€ + Te hyrat vetanake 0.00€ dhe 2,452.35€ nga donacionet.

Realizimi i buxhetit për investime kapitale në total është 15,000.00€, prej tyre (15,000.00€ nga Grandi + 0.00€ nga të hyrat vetanake + 0.00€ nga të hyrat e bartura dhe 0.00€ nga Donacionet).

Progresi i realizimit të investimeve Kapitale karshi mjeteve të alokuara për periudhën Janar – Mars të vitit 2021 është 47.23%.

PASQYRA E OBLIGIMEVE TË PA PAGUARA JANAR– MARS 2021

Programet Buxhetore	M&SH	Komunal	Subvencione	Kapitale	Gjithsej	Borgji momental	Pagëzimet deri më 01/03/2021
	-	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ							

Të arkëtueshmet

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2021 € '000
40110	Tatim në prone	231,358.05
50019	Licenca (Ushtrimi i veprimtarisë)	63,645.00
50408	Qiraja nga objektet publike	3,172.50
Gjithsej		298,175.55

❖ REKAPITULLIMI I INFORMATËS FINANCIARE

Kjo informatë periodike Janar – Mars / 2021 ka për qëllim informimin detal dhe objektiv për të gjithë treguesit financiar, qofshin pozitive apo negative.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që rezultatet pozitive të menaxhimit të këtij buxheti të forcojmë dhe të rrisim më tutje, ndërsa treguesit negativë të eliminojmë gjatë periudhave në vijim. E tërë kjo me qëllim që të jemi sa më të suksesshëm në realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për qëllimet e përcaktuara me planet dinamike të veprimit sipas ligjit mbi Buxhetin.

❖ PLANIFIKIMI BUXHETOR JANAR - MARS 2021

Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi Komunal në vlerë 1,546,704.00 € ka pasur ndryshime – rritje në periudhën Janar - Mars 2021 për: 2,469.85 € nga mjetet e pranuar nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2020, 6,089.93€ nga mjetet e pranuar nga niveli Qendror. Do të thotë buxheti total për vitin 2021 ka vlerën: 1,555,263.78€.

❖ SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE JANAR - MARS 2021

- Shpenzimet nga Grandi qeveritar: Komuna ka pranuar mjete në vlerë 404,740.91€ ka shpenzuar 353,090.84€ që do të thotë 87,24% të mjeteve të alokuara.
- Shpenzimet nga të hyrat vetanake: Mjetet e alokuara nga ky burim janë 14,717.40€, janë shpenzuar 500.00 € që do të thotë 3,40% të mjeteve të alokuara.
- Shpenzimet nga Mjetet e bartura të viti paraprak: Nuk janë të bartura në këtë periudhë të raportimit.
- Shpenzimet nga Donacionet dhe Participimet: Nga mjetet e pranuar në vlerë 2,469.85€ janë shpenzuar 0.00€ ose 0.00% të mjeteve të alokuara – pranuar.
- Ne përgjithësi në këtë periudhë Janar - Mars 2021 vlen të përmendet efikasitet i lartë në menaxhimin e buxhetit (pagesa) 83.80% e mjeteve të alokuara buxhetore, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi shpenzime më të larta prej 12.84%.

❖ TË HYRAT BUXHETORE PERIODIKE JANAR - MARS 2021

- Të Hyrat Vetanake: Komuna ka realizuar dhe alokuar të hyra vetanake në periudhën Janar - Mars 2021, me donacione 37,211.45€ ose 8.82% të alokimeve prej 421,928.16€.

- **Pengesat që kanë ndikuar në rezultate edhe më të mëdha janë:**

1. Grandi Qeveritar jo i mjaftueshëm për realizimin e aktiviteteve të parapara nga Komuna dhe kufizimet në planifikimin e shpenzimeve operative.
2. Situata e krijuar pas shfaqjes së pandemisë COVID 19

Duke pasur parasysh indikatorët e lartë cekur Komuna e Junikut, në Periudhën Janar –Marz 2021 ka arritur rezultate të mira të cilat u bënë të ditura më lartë.